

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder
Vitet I i botimit, Gusht 2007 Nr 4. Çmimi 20 lekë. www.gazetabesimtari.com



Pirro Prifti, andarti i
Janullatosit që kërkon të
ortodoksizojë Shqipërinë

Olsi Jazexhi

Fq 2

Etika Islame

Gazjon Rusi

Fq 3

Diplomacia nderkombetare
po realizon copetimin
e Kosoves

Selim Gokaj

Fq 4

Konferenca Islamike
eshte njezeri per
pavaresine E Kosoves

H. Vehbi Dani

Fq 5

Zoteria i luftes

Ismet Zaganjori

Fq 6

Dave apo politike

Kasem Zylja

Fq 7

Jeta dhe veprimtaria
e Jusuf Efendi Tabakut

Fq 8

Perralla me autobombat ne
tentative ne Angli

Selim Gokaj

Fq 10

FITORE MADHERSHTORE E KRYEMINISTRIT ERDOGAN NE ZGJEDHJET PARLAMENTARE NE TURQI



Agjensia turke e lajmeve "Anatolia", në emisionin kryesor të lajmeve, dha njoftimin se zgjedhjet parlamentare në Turqi i kishte fituar, me një shumicë dërmuese, partia e kryeministrit të sukseshëm, Taip Rexhep Erdogan. Rivalja e saj, Partia Popullore Republikane, kishte dale e humbur duke siguruar vetëm 20% të votave dhe 111 deputetë, përballë 46.4% dhe

361 deputetëve të partisë së kryeministrit Erdogan. Ky rezultat tregoi se partia muslimane e moderuar fitoi tre here më shumë se partia laike që është vazhdim i ideve të Qemal Atatürkut, parti që duket se akrepi i ores së saj po shkon prapa

, pozicion në të cilin po e vë vota e qytetarve të Turqisë, të cilët duket se e shikojnë këtë parti si një relike që nuk ka të bëjë më me

historinë dhe shpirtin e popullit turk.

Axhensia e lajmeve turke tha se pjesëmarrja në votime ishte masive dhe votimet u zhvilluan normalisht duke treguar edukatën qytetare të popullit turk dhe njëkohësisht edhe interesimin e jashtzakonshëm për të marrë pjesë në këto zgjedhje, të cilat kishin shumë rëndësi për rrugën në të cilën do të ecë në të ardhmen shteti turk. Axhensitë e huaja të lajmeve dhe opinjoni publik botëror e shikoi mbështetjen që i dha populli z. Erdogan si rezultat i një politike të drejtë ekonomike, që duket tek rritja galopante e ekonomisë turke në qeverisjen e partisë së z. Erdogan dhe tek një politike e drejtë dhe e ekuilibruar ndërkombëtare, duke ruajtur gjithmonë të drejtat dhe krenarinë e shtetit turk përballë presioneve dhe kurtheve të diplomacisë së klubit të krishterë evropian.. Megjithatë edhe në këto zgjedhje partia e z. Erdogan nuk i fitoi 2/3, për të zgjedhur e vetme presidentin e republikës, ajo i ka shanset të plota tashmë që ta zgjedhe presidentin në aleancë me partitë që kanë hyrë në parlamentin e ri, të cilat nuk janë në një linjë me partinë laike të Atatürkut, që e kundërshton kandidaturën që propozon partia që ka tashmë ka shumicën në parlament, me motivin se një president islamik e rrënon laicizmin në Turqi.

Me fitoren mahnitëse, që arriti në këto zgjedhje Partia e Z. Erdogan, ajo tregoi se është një parti me mbështetje kombëtare dhe e hapur për të gjithë, gjë që u duk tek

pjesëmarrja e elementit kurd, që arriti të çojë në parlament 27 deputetë me siglën e deputetit të pavarur.

Portretin e saktë të partisë së z. Erdogan do ta bënte një politikan i njohur turk i cili do të kandidojë dhe do të fitojë si deputet i kësaj partie.

Ai do të deklarojë; "Partia e kryeministrit Erdogan është formacioni politik më përparimtar dhe më progresist në spektrin politik të Turqisë në ditët e sotme.

Është e mire dhe e drejtë që lexuesi të jetë në dijeni dhe të njohë qëndrimin e mediave shqiptare dhe të vetë politikës shqiptare për zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në Turqi. Është për të ardhur keq që mediat dhe politika shqiptare filluan një fushatë të heshtur, por fort djegëse, kundër partisë së Z. Erdogan, duke e etiketuar si parti filoislamike dhe drejtuesit e saj, Erdogan dhe Abdulla Gyl, si muslimanë të devotshëm, thuajse bëhej fjalë për parti kriminelësh dhe kriminelë që do të bëhen presidentë në Turqi, i cila, me këtë parti dhe me këto drejtues do të rrokullisej në humnerë. Edhe pas fitores madheshtore të Z. Erdogan, mediat tona mbetën si të mpira dhe nuk munguan të paraqesin pamje, ku pozonin fituesit me grate e tyre me hixhab

duke na bindur se drejtuesit e këtyre mediave dhe ato që janë pas tyre janë të pikëlluar që Erdogan dhe Abdullall Gyl nuk i kanë grate e tyre të veshura me minifunde dhe me dekolde si janë të veshura gratë

në Evropën "E Përparuar" së cilës tashmë i kanë mbetur në vend akrepet e orës së moralit.

Mediat dhe politika shqiptare e kalojnë në heshtje faktin se Turqia është i vetmi vend, ku, në shqiptarët, udhëtojmë pa vizë

dhe është i vetmi vend me të cilin marrëdhënjet ekonomike kanë ecur përpara pa elementë të korrupsionit. Është pikërisht shteti turk që instaloi klinikat e tij të famshme në Tiranë, për të kuruar shqiptarët me parametrat me të lartë mjekësorë dhe në rastet, kur pacientët janë me mundësi të kufizuara ekonomike, ata e kanë mjekim falas.

Tashme zgjedhjet në Turqi kanë përfunduar dhe së shpejti turqit do të kenë qeverinë e tyre të re, me kryeministrin fitimtar,

. Erdogan.

E vërteta është se diplomacia perendimore e njohu dhe e pershendeti fitoren e partisë islamike të moderuar të z. Erdogan,,

sepse kjo diplomaci nuk mundi të penalizojë votimet e rregullta dhe masive që beri votuesi turk.. Por, deklaratat se Turqia nuk i ka arritë parametrat për të hyrë në BE, nuk munguan, duke treguar se kryeministri Sarkozy ka shumë partnerë pas tij të cilët nuk mund t, i marrë gjumi me një Turqi në BE që ka një popullsi absolute muslimane, Me këtë qëndrim kundër Turqisë, diplomacia ndërkombëtare ka dëshmuar se vazhdon të notojë në psikologjinë e kryqzatave që imasakruan dhe e gjakosën muslimanët në vendet e tyre, ku ato jetonin në paqë pa i bërë dëm askujt.

Por, Perendimi nuk mund ta vazhdojë gjatë lojën e standarteve me Turqinë,, sepse ajo nuk do të arrijë kurrë të anashkalojë

dhe të penalizojë fuqinë më të madhe në NATO, pas SHBA, e cila tashmë po marshon përpara me ritme të larta edhe si një shtet i fuqishëm ekonomik, me piksynimin për të qenë pjesë e kupolës së ekonomisë botërore

SELIM GOKAJ

Shkoder me 30 korrik 2007

Pirro Prifti, andarti i Janullatosit që kërkon të ortodoksizojë Shqipërinë

Olsi Jazexhi

Në vitin 1915, kur austriakët dhe italianët po mundoheshin me të gjitha forcat të krijojnë shtetin shqiptar në kufijtë që ne njohim sot Shqipërinë, në jug të atdheut tonë, apo më saktë në qytetin e Korçës, disa të krishterë ortodoksë ishin mobilizuar nëpër repartet e shenjta të andartëve grekë dhe me ato vrisnin, përdhunonin dhe zhduknin muslimanët e jugut të Shqipërisë. Eshref Frashëri i cili në këtë kohë ishte në Korçë, në një letër që ndodhet ende sot e kësaj dite në arkivin kombëtar, i tregonte Mithat Frashërit që të krishterët e Korçës, të cilët për sa kohë ishte Turqia hiqeshin si patriotë dhe kishin bashkëpunuar me muslimanët, tanimë ishin kthyer kundër muslimanëve të cilët nuk i pranin për shqiptarë por i quanin turq dhe donin ti çojnë në Azi.

Replikat që z. Pirro Prifti ka bërë këto ditë me zotit Shefqet Musaraj, ku Pirrua në shkrimin e tij të datës 13 korrik kërkon që të kristjanizojë shqiptarët, shkruesit të këtij shkrimi i sollën ndërmend disa nga ortodoksët e Korçës, Bilishtit dhe Kolonjës gjatë viteve 1915, të cilët deshën që ose të konvertojnë shqiptarët në të krishterë ose ti dëbojnë për në Turqi. Z. Pirro Prifti i cili me profesion është doktor dhe në Qendrën Spitalore Nënë Tereza ku ai punon, paguhet me paratë e taksapaguesëve myslymanë shqiptarë, ka disa vite që propagandon lartë e poshtë idenë e konvertimit të shqiptarëve muslimanë në të krishterë të ritit grek, dhe unifikimin e katolikëve me ortodoksën. Edhe pse në shkrimin e tij të datës 13 korrik ai thotë që *'Megjithatë ka shpresa; arsimimi duhet, por duhet ngritur kolona e moralit fetar (besimi unik fetar) nëpërmjet një unifikimi fetar kristian të ngadaltë dhe pa dhunë. Atëherë Shqipëria do të marrë frymë lirisht ashtu si ka dhe simbolin e flamurit të Gjergj Kastriotit'*, synimi i tij afatgjatë duket të jetë konvertimi me dhunë i shqiptarëve muslimanë në ortodoks, ashtu siç donin andartët e Korçës në vitin 1915.

Në librin *'Të Penduarit ose Kombi Përballë Zotit'* të botuar në vitin 2002, në letrën që Pirro Prifti i dërgon gjeneralit grek Anastos Janullatos, ku Pirrua e përshkruan veten e tij si *'njeriu me i zakonshëm dhe më i fundit i Kishës Ortodokse'*, ai i shpreh gatishmërinë e tij z. Janullatos për rikonstruim fetar në Shqipëri. Pjesë të kësaj rikonstruimit Pirrua parashtron edhe ortodoksizimin e historisë së Shqipërisë dhe heronjëve të saj. Pirro Prifti i cili ha bukë nga paratë e taksapaguesëve muslimanëve shqiptarë në Qendrën Spitalore Nënë Tereza, i apelon gjeneralit Janullatos që Skënderbeun, të cilin shqiptarët e kanë hero laik kombëtar, ta shpallë hero dhe shenjtor të ortodoksisë. Për Pirron, lënia e Skënderbeut jashtë shenjtërimit ortodoks deri më tani është një padrejtësi. Ai i kërkon Janullatosit që Kisha ta shpallë Skënderbeun shenjt ortodoks, siç ka shpallur edhe Princin shqiptarvrasës të Serbisë, Llazarin dhe bekuar luftën e Serbisë kundër Perandorisë Osmane dhe muslimanëve kosovarë. Për të bindur Janullatosin që Skënderbeu nuk ka lidhje as gjakësore dhe as fetare me shqiptarët e sotëm muslimanë, por është i të njëjtit gjak dhe fe me sllavët dhe ortodoksët, Pirrua i shkruan Janullatosit se *'heroi ynë ishte ortodoks si nga e ëma ashtu edhe nga i ati'* dhe se *'të gjithë bijat dhe motrat e Skënderbeut u martuan me princër shqiptarë dhe sllavë ortodoksë'*. Duke argumentuar në këtë mënyrë Pirro Prifti kërkon të bindë kolonelin Janullatos për pastërtinë rracore dhe fetare të Skënderbeut, i cili ndryshe nga çamët islamikë të cilët Janullatosi refuzon të lutet për, del të jetë kampion i ortodoksisë. Për të bindur Janullatosin që Pirroja është njeriu më i bindur dhe i betuar i hirësisë së tij, ai e mbyll letrën duke i thënë: *'Do ti lutem Zotit, Hirësia Juaj që të merrni në konsideratë një letër të tillë... dhe për hir të postit tuaj të nderuar, të pa-anshmërisë Tuaj, të ndershmërisë tuaj, të besimit të Zoti Jezu Krisht me emrin e të cilit vdiq heroi ynë kombëtar të bëni përçapjet tuaja për të realizuar këtë detyrë.'*

Ndërsa Pirrua kërkon nga gjenerali Janullatos që të shenjtërojë Skënderbeun si shenjt sllavo-greko-ortodoks, i njëjti Pirro që kërkon të unifikojë fetarisht në të krishterë shqiptarët muslimanë, nuk i ka shkruar kurrë gjeneralit grek Janullatos që të shenjtërojë apo qoftë edhe të mbajë meshë për çamët e vranë nga greko ortodoksia gjatë shekullit të 20të. Arsyeja për këtë është e qartë. Siç ai shkruan në shkrimin *'Replikë e detyruar për z. Shefqet Musaraj'* të datës 19 korrik 2007, sipas historiografisë ortodokse në Ballkan *'shumica dërmuese e popullit shqiptar'* që është muslimane, tregohet të ketë *'qenë*

kristiane konvertuar në 99% të rasteve me dhunë' ndërsa *'një pjesë e vogël e tyre janë të ardhur dhe të asimiluar këtu'*. Llogjika që Pirro Prifti përdor edhe në librin e tij teologjik *'Të Penduarit ose Kombi Përballë Zotit'*, është e njëjtë me atë që pan-ortodoksët përdorin sot kudo; në Kosovë kundër shqiptarëve, në Bosnje kundër boshnjakëve, në Qipro kundër turqve, në Çamëri kundër shqiptarëve etj. Tamam si pan-ortodoksët e tjerë edhe Pirrua shqiptarët muslimanë i vendos përpara 2 fatesh. Një, që të pranojnë statusin e tyre që ju ka dhënë propaganda e ortodoksisë, si dobëtakë, legena dhe servilë të konvertuar nga frika ndaj turkut në muslimanë (dhe jo nga superioriteti i islamit ndaj krishtërit që ne besojmë); ndërsa sivëllezërit e tyre serbë dhe grekë janë trimat që ishin dhe ndejtën të krishterë, apo; dy, të pranojnë që janë ardhacakë nga Azia, të cilët siç edhe vllëhet dhe grekërit e Korçës thonin në 1915, duhet të çohen për në Azi.

Kombi që Pirro Prifti shpreson të ndërtojë nëpër shkrimin e tij dhe letrën që i ka çuar Janullatosit, duket qartë që nuk është Shqipëria dhe për më tepër shqiptarët muslimanë. Për këtë arsye në faqen 155 të librit të tij, Pirro Prifti sulmon nipin e Abdyl Frashërit, Mehdi Frashërin, kur Mehdiu gjykonte në vitet 30'të që marrja e Shën Naumit nga Jugosllavët në shekullin e 20të nuk ishte ndonjë hata për kombin shqiptar, pasi shën-naumasit ishin vllëho-maqedonë. Por kombi që Prifti Pirro kërkon të ndërtojë në Shqipëri është kombi i pan-ortodoksisë i cili shtrihet që nga Shën Petërburgu, në Athinë, Shën Naum dhe Qipron Greke. Jo më kot në letrën që Pirrua i shkruan Janullatosit, i kërkon që të shenjtërojë Skënderbeun si shenjt ortodoks, në mënyrë që të gëzohen *'Komunitetet Ortodokse në Shqipëri'* (lexo vllëhet, grekët, malazezët, shqiptarët ortodoksë etj) dhe *'çdo vend Ortodoks.'* Llogjika që Pirro Prifti përdor në shkrimin e tij është e njëjtë me deklaratën e prevezarit Janullatos, gjyshërit e të cilit i kanë grabitur me dhunë tokat shqiptarëve myslymanë të Prevezës pas Kongresit të Berlinit. Në intervistën me titull *'Janullatos: Nuk jeni komb tipik musliman'* dhënë radios Doice Velle në datë 18 maj 2007, Janullatosi e përshkruan Kishën Ortodokse si një urë lidhëse të Shqipërisë me Pan-ortodoksën. Të njëjtën gjë synon edhe Pirro Prifti i cili me shenjtërimin e Skënderbeut në Ortodoksi kërkon që të ndërtojë urën fetare, e cila do të gëzojë çdo vend Ortodoks duke i zhytur një shenjtor ortodoks si hero kombëtar Shqipërisë.

Pirro Prifti i cili mbahet me bukë nga ministri demokristian i shëndetësisë Nard Ndoka, i cili propozoi përpara ca ditësh që president të Shqipërisë të shpalli një tjetër minoritar si Pirro Prifti, Spiro Peçin, duket se nuk e njeh mirë apo e ka harruar historinë e jugut të Shqipërisë. Ndërsa ai kërkon që t'iu marrë shqiptarëve herojtë kombëtarë dhe vaftisë në ortodoksë dhe kristjanizojë shqiptarët muslimanë, duket se ashtu si Janullatosi kërkon të përsërisë atë që gjyshërit e tyre dështuan të bëjnë në mënyrë të dhunshme në Jugun e Shqipërisë në 1915. Pirrua që beson direktivat e kolonelit Janullatos, i cili deklaron se shqiptarët sot janë 30% ortodoksë, përsërit ato që shkrimtari Foto Malo shkruan në gazetën "Zëri i Omonias" (pararobje e shovinizmit grek) i cili vite më parë ftonte *'shqiptarët myslymanë të rishikojnë e korrigjojnë gabimin e tyre historik, imponues e të dhunshëm, që kanë kryer në të kaluarën, duke u rikthyer në besimin e tyre të krishterë, meqënëse vetëm kështu mund të hyjnë në Evropë.'*

Pirro Prifti dhe Foto Malo të cilët prof. Sherif Delvina i ka quajtur me të drejtë shkrimtarë në shërbim të shovinizmit grek, harrojnë historikun e Shqipërisë, kur shkruajnë të eksituar nga dozat e indoktrinimit Janullatist për të konvertuar shqiptarët muslimanë në të krishterë. Pirrua, që rrjedh nga reajatë (besoj vllëhet apo shulet) e Devollit, duhet ta ketë fare mirë paraysh se çfarë pësuan andartët e unifikimit kristjan, që deshën *'enosia i thanatos'* (unifikim apo vdekje), nga çetat e myslymanëve korçarë dhe kolonjarë të Sali Butkës dhe Malkë Zarishtit në vitet 1915. Nëse nuk e njeh historinë le të shkojë njëherë në Bilisht dhe të këndojë me devollitët myslymanë këngën e 'Ishti Bilishtit', pse ndoshta zbulon mesazhin e zotit të tij, Jezu Krishtit dhe atë muhabetin e hyrjes së gishtit... në krishtërim padyschim.



DEKLARATE

Shoqata Bamirese Shkoder ,Shoqata e Intelektualeve Shqiptar ;;Kultura Islame;; dega Shkoder, Forumi Musliman Shqiptar dhe Klubi Kulturor Drita Shkoder. permes kesaj deklarata, qe behet ne emer te anetaresise muslimane qe perfaqesojne keto shoqata, shpreh zemrimin dhe indinjaten e saj te thelle per racizmin dhe ksenofobine e policise grake e cila, permes pamjeve qe u pane ne nje kasete qe trasmetuan mediat greke, ushtronte dhune te ashper fizike ndaj emigranteve shqiptare qe beheshin pre e goditjeve me shkop nga policet raciste greke. Per t,I poshteruar, policet greke I detyronin te rinjte shqiptare te goditnin njeri -tjetrin duke bere qe zemrimi yne te ishte shume I madh. Ne I bejme thirrje qeverise greke te nderhyje per te ndaluar aktet e dhunes dhe te racizmit ,sepse veprime te tilla prishin mardhenjet ne mes te dy popujve Nga ana tjetere, ne I kerkojme qeverise shqiptare qe te interesohet me shume per shtetasit e saj dhe te mbroje interesat e tyre duke nderhyre prane autoriteteve greke per te denuar fajtoret dhe per te ndaluar ne menyre te prere perseritjen e ketyre akteve te turpshme qe I vene nje njolle te zeze demokracise ne Greqi e cila eshte edhe pjese e Evropes se Bashkuar qe ne shqiptaret e marrim per model te demokracise e cila ka kaq shume demokraci, sa edhe "e eksporton" ne vendet ku kjo demokraci mungon Mendojme se Greqia po behet ngadale nje vend qe duhet te eksportoje pak demokraci qe te permiresoje imazhin e saj racist ndaj shqiptarve dhe emigranteve te tjere. Ne, si shoqata muslimane, jemi te bindur se akte te tilla nuk duhet te ndodhin me qe ne, si dy popuj qe jetojme me shekuj prane njeri- tjetrit, te mos jetojme ne urrejtje, por te jetojme ne nje miqesi te sinqerte me njeri tjetrin

Shkoder ,me 7 korrik 2007

Shoqata Bamirese Shkoder
Forum Musliman Shqiptar
Klubi kulturor Drita Shkoder
Shoqata e intelektualeve Muslimane
"Kultura Islame" Shkoder



ETIKA ISLAME

Me fjalën etikë kuptojmë mënyrën e të sjellurit me njerëzit, shpirtin e bukur dhe vlerësimin e asaj që është e bukur dhe e mire. Kuptojmë pastërtinë shpirtërore, rregullin etj...

Etika ose edukata është nga bazat e moralit islam. Shumë njerëz mendojnë se etika nuk ka të beje me xhaminë dhe fenë, por me shkollën dhe institute të veçanta që merren me këtë fushë. Nga mënyra se si e kuptojnë termin etikë, shoqëria jone ndahet në katër grupe:

1- Ata që mendojnë se etika e ka burimin në vlerat përëndimore.

2- Njerëz që janë edukuar me sjellje të mire në shtëpitë e tyre dhe mendojnë se Islami është diçka e kundërt e edukatës. Aq sa kur dëgjojnë mbi ndonjë fetar, e imagjinojnë si gogol, të pasjellshëm, të pa rregull etj...

3- Njerëz që mendojnë se feja është vetëm brenda xhamisë, kurse jashtë saj janë njerëz të tjerë.

4- Të rinj që fenë e kanë kuptuar vetëm si adhurim, falje, agjërim, lutje etj., dhe nuk kanë edukatën e duhur në marrëdhëniet me njerëzit. Ky grup ka ndikuar për keq në tre grupet e para, për të formuar një ide jo të mire rreth fesë.

Qëllimi ynë është që nëpërmjet kësaj teme të arrijmë të bindemi se edukata e mire, burimin e ka nga Feja Islame. Edukata ndahet në tre pjesë:

1- Edukata me Zotin.

2- Edukata me Profetin Muhamed (a.s.).

3- Edukata me krijesat.

Duke parë gjerësinë e kësaj teme është e pamundur ta trajtojmë të gjithën në një artikull të vetëm prandaj po zgjedhim vetëm njëri konkretisht etikën me krijesat dhe po fillojmë me krijesat më të dashura pas profetit a.s. që janë prindërit.

Me **edukatën me prindërit** nuk duhet të nënkuptojmë respektin ndaj tyre, por etiken dhe mënyrën se si të sillemi me ta.

Njeri prej shokëve të Profetit (a.s.), kur i erdhi vdekja, nuk e shqiptonte dot shehadetin. Megjithëse të pranishmit u munduan ta ndihmonin, ai nuk e shqiptonte dot. Atëherë shkuan disa të Profeti (a.s.) ta pyesin. Profeti (a.s.) pasi i dëgjoi, i pyeti nëse kishte ndonjërin nga prindërit gjalle. I thane se ka nënën. Shkuan të nena e tij ta pyesin për djalin se si ishte sjellur me të. Nena u tha se kishte qene djale që e kishte respektuar, por gjithmonë kur u çonte fruta gruas dhe fëmijëve të tij dhe ushqime të freskëta, mua me jepte çfarë tepronte prej tyre. Nga kjo ai nuk mund të vdiste me shehadet. Atëherë Profeti (a.s.) ndezi një zjarr dhe i tha nënës që do ta djegin në zjarr birin e saj, për t'i zbutur zemrën dhe ta falte. Ashtu ndodhi, në çastin që nena e fali, djali tha shehadetin dhe vdiq.

Nga edukata me prindërit është se në çaste të caktuara, fëmijët duhet të kërkojnë leje për të hyre në dhomën e gjumit të prindërve. Ketë e përmend Zoti i Madhëruar në Kuran: **“O ju që keni besuar! Le të kërkojnë lejen tuaj robërit dhe robëreshat e ligjshme dhe ata nga familja e juaj që nuk kanë arritur moshën e pubertetit, para se të hyjnë te ju, në tri raste: Para faljes së sabahut, kur të zhvisheni për pushimin e drekës si dhe pas faljes së jaciesë.”** (Nur, 58)

Një burrë e pyeti Profetin (a.s.): -"O i Dërguar i Zotit, a t'i kërkoj leje për të hyre dhe nënës time?" -"Po", -i tha Profeti (a.s.). -"O Profet, t'i kërkoj leje nënës time?" -"Po", -i tha Profeti (a.s.) përsëri. -"O Profet, a t'i kërkoj leje për të hyre nënës time?!" -"Po", -i tha për të tretën here Profeti. -"A do të dëshiroje ta gjeje nënën tendë lakuriqe?" -"Jo", -i tha burri. -"Atëherë kërkoj leje para se të hysh".

Etika me bashkëshorten.

Shpeshherë shohim ndonjë film, ku çifti shkon për të ngrënë në një restorant. Shohim burrin që ushqen gruan me dorën e tij dhe habitemi për edukatën dhe dashurinë mes tyre. Kurse Profeti (a.s.) këtë veprim e ka nxitur qysh para 1400 vjetësh, duke thënë: **“Lëmosha me e madhe është kafshata që e vendos në gojën e gruas tendë”**.

Gratë e Profetit (a.s.) banonin pranë xhamisë, e cila ishte pjesë shkretëtire. Kur Profeti (a.s.) u martua me Marien nga Egjipti, nuk e vendosi bashke me të tjerat, pasi ajo nuk ishte mësuar me shkretëtirën, por e vendosi në një vend që në atë kohë quhej "avali", i cili ishte vend i gjelbër.

Gjate menstruacioneve, gjendja shpirtërore e gruas ndryshon. Për këtë gjë, ajo duhet të trajtohet me butësi. Nena e Besimtareve Aisheja tregon se kur pija ujë gjatë menstruacioneve, Profeti (a.s.) e merrte enën (ku piva unë) dhe pinte në të njëjtin vend ku kisha pive unë.

Nga etika me gruan është që të dish dhe dobësitë e saj. Njëherë Aisheja ndërsa po rrinte me Profetin (a.s.) e ngriti zërin ndaj tij. Në atë çast vjen Ebu Bekri, babai i saj dhe kur e dëgjoi këtë u bë gati ta qëllonte. Por Profeti (a.s.) e ndaloi dhe i tha: 'Nuk kishim nevojë për këtë, o Ebu Bekr'.

Kur u largua Ebu Bekri, për ta zbutur gjendjen, Profeti (a.s.) i thotë Aishes: "A epe se si e ndalova ndaj teje?" dhe Aisheja filloi të qeshe.

Një dite Aisheja po i tregonte Profetit (a.s.) mbi 10 histori të ndryshme çiftesh. E fundit ishte historia e Ebu Zerit që e kishte dashur shumë gruan e tij dhe ia kishin kaluar shumë bukur, por në fund e kishte ndare. Pasi përfundoi Aisheja së treguari, Profeti (a.s.) i thotë: Jam për ty si Ebu Zeri për gruan e tij, veçse unë nuk të ndaj".

Shumë burra sot tregohen inferiorë ndaj grave të tyre, duke i lënë pas dore. Punon gjithë ditën, vjen në mbrëmje, merr lexon gazetën deri sa e zë gjumi, duke u shkujdesur për nevojat e gruas. Gratë e Profetit (a.s.) tregojnë për të, duke e përshkruar se si ishte brenda shtëpisë: "I Dërguar i Zotit, gjithmonë ishte i buzëqeshur dhe na bënte të qeshnim, ulej e bisedonte me ne dhe bisedonim me te...". Sa familje prishen për shkak të edukatës së dobët me gruan!

Nga etika me gruan është se ashtu siç kërkon që ajo të zbkurohet për ty, edhe ti të zbkurohesh për të. Abdullah bin Abbasi, njeri nga shokët me të ditur të Profetit (a.s.) thotë: "Unë zbkurohem për gruan, ashtu siç dua që ajo të zbkurohet për mua".

Etika Islame na mëson edhe mënyrën se si të flemë me gratë. Zoti i Madhëruar thotë në Kuran: **“Gratë tuaja janë burim i vazhdimësisë suaj, kështu që afrojuni këtij burimi kur dhe si të doni...”** (Bekare, 223) Profeti (a.s.) lidhur me këtë gjë thotë: **“Marrëdhëniet intime mes burrit dhe gruas nuk duhet të jene si ato të kafshëve, por le të fillojnë me përkëdhelje dhe fjalë të bukura”**.

Nga Tradita Profetike është se burri nuk duhet të hyjë menjëherë në shtëpi, por të trokasë, të prese për një çast, pastaj të hyje. Kjo gjë bëhet për shkak se nëse gruaja brenda shtëpisë është e parregullt, të ketë mundësi të rregullohet.

Etika dhe edukata jashtë shtëpisë.

-Mënyra e të ecurit.

Shokët e Profetit (a.s.) tregojnë se Profeti (a.s.) kur ecte, shpejtonte, por nuk vraponte. **“Dhe robërit e Zotit, të çilet ecin mbi toke me përulje (jo kryelarte) dhe me qetësi dhe kur u drejtohen atyre të paditurit (me fjalë të këqija) ata ua kthejnë me fjalë të buta e mirësi...”** (Furkan, 63)

Shume njerëz përdorin borinë e makinës, ose thërrasin me zë të lartë kur duan të tërheqin vëmendjen e dikujt, gjë e cila është jashtë normave të moralit.

Kur një grup njerëzish erdhën tek Profeti (a.s.) dhe filluan ta thërrasin me zë të lartë, Zoti i Madhëruar i qortoi në Kuran: **“Vërtet se ata që të thërrasin nga pas shtëpive, shumica e tyre nuk gjykojnë. Dhe po të kishin durim deri sa të dilje jashtë do të ishte me mire për ta”**. (Huxhurat, 4)

Nëse një grup njerëzish janë ulur në një kuvend dhe vjen dikush tjetër, është mire që t'i bëjnë vend edhe atij. Zoti i Madhëruar thotë në Kuran: **“O ju që keni besuar, kur t'ju thuhet të hapni vend neper kuvende, (hapuni) bëni vend që Allahu t'ju beje vend (në mëshirën e Tij)”**. (Muxhadele, 11)

Umer bin Hattabi thotë: “Tre gjera të bëjnë t'i fitosh zemrën tjetrit: ...dhe të besh vend për të kur të vije te ulet”.

Një dite teksa Profeti (a.s.) po rrinte në xhami, vjen një fshatar. Profeti (a.s.) megjithëse në xhami kishte plot vend për tu ulur, lëvizti nga vendi. Fshatari i tha: -“O i Dërguar i Zotit, mos lëviz pasi në xhami ka vend plot” - Profeti (a.s.) ia ktheu: - **“Është detyre e çdo muslimani kur t'i vije dikush të lëviz nga vendi”**.

Nga etika islame është edhe mos-hedhja e mbeturinave në rrugë. Profeti (a.s.) thotë: **“Heqja e mbeturinave nga rruga është lëshim”**. **“Besimi është gjashtedhjetë e ca dege. Me e larta prej tyre është dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç një Zoti dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij. Kurse me e ulëta është heqja e mbeturinave nga rruga”**. Pra, shohim që heqja e mbeturinave nga rruga është pjesë e besimit. Kjo, jo vetëm në rrugë, por dhe në mes të shkretëtirës sikur të jesh.

Këtu futet edhe pëshytyra në rrugë, pasi Profeti (a.s.) thotë: **“Edhe engjëjt i urrejnë ato gjera që njerëzi i urrejnë”**.

Një dite Profeti (a.s.) u tha shokëve: - **“Mos u ulni në rrugë”**. “Po si t'ia bëjmë, -i thane ato, - pasi aty ulemi dhe kuvendojmë?” **“Nëse doni të uleni, - u tha Profeti (a.s.), - i jepni rrugës të drejtën që i takon”**. “Po, cila është e drejta e rrugës?” - e pyeten shokët. **“Te ulni shikimin, te mos i bëni keq kujt, të ktheni përshëndetjen, të urdhëroni për të mira dhe të ndaloni nga veprat e liga”**.

Etika e vizitës dhe e mikpritjes.

Kur të vizitosh dike, sipas Fesë Islame është mire ta njoftosh me përpara që të pres. Zoti i Madhëruar thotë në

Kuran: **“O ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë që nuk janë tuajat, derisa të kërkon leje dhe të përshëndeteni me ata që janë në to. Kjo është me mire për ju, me qellim që të mund të përkujtoni”**. (Nur, 27) Vete fjala "testenisu", të orienton që ta kuptosh nga mënyra e të folurit nëse është i gatshëm të të prese apo jo. Nëse nuk është i gatshëm të të prese, mos u mërzi. **“Dhe nëse u thuhet kthehuni, kthehuni pasi kjo është me mire për ju”**. (Nur, 28) Pasi ta kesh njoftuar dhe ke shkuar të shtëpia, mos u fut brenda pa trokitur ose t'i biesh ziles. Kjo arrihet duke trokitur vetëm tre here, duke prituar pak pas çdo të trokiture, me qellim që t'i japësh kohe që të behet gati nëse është i zënë me diçka. Profeti (a.s.) thotë: **“Trokitja është tre here dhe nëse nuk të jepet leje të hysh, largohu”**. Pasi t'i kesh rënë ziles, mos qëndro drejt derës, por djathtas ose majtas saj. Profeti (a.s.) thotë: **“Mos qëndroni drejt derës, por djathtas ose majtas”**. Nëse të pyesin se kush është, mos u thuaj “unë”, por thuaju emrin tënd.

Kur Xhabir ibni Abdilal shkoi të shtëpia e Profetit (a.s.) dhe trokiti në derë, Profeti a.s. nga brenda pyeti se kush është. “Unë, - thotë Xhabiri, iu përgjigja nga prapa derës, - unë, o Profet”. Atëherë e dëgjova Profetin të thoshte: “Unë, unë, unë...” sikur nuk i pëlqeu përgjigjja ime. Kur të hysh brenda, mos kërko gjë nga mikpritësi, si disa njerëz që kur shkojnë për vizite, kërkojnë të përdorin telefonin e mikpritësit etj. Profeti (a.s.) thotë: **“Ajo gjë që merret nga turpi, është haram”**.

Nga edukata e vizitës është që të mos qëndrosh gjatë për vizitë. Një nate, kur Profeti kishte ftuar shokët e tij për darke, ata qëndruan deri natën vone. Te nesërmen, Profetit iu shpall në Kuran për këtë: **“Por kur të ftoheni, hyni dhe kur të keni mbaruar se ngrëni, shpërndahuni pa qëndruar për biseda...”** (Ahzab, 53) Dikush shkoi për vizite tek imam Shafiu dhe ngaqë qëndroi gjatë, kur u nis të çohet i tha: -“Kam frikë se të rendova, o imam”. -Ti me rëndon edhe kur je në shtëpinë tëndë, ia ktheu imam Shafiu.

Kur të hysh në shtëpinë e mikut, ulu ku të thotë mikpritësi dhe jo ku të duash ti. Profeti (a.s.) thotë: **“Mos te ulet askush prej jush në vendin ku ulet i pari i shtëpisë, veçse me lejen e tij”**. Vizita e të sëmurve është nga tradita e Profetit (a.s.) dhe nga porosite e tij. Por mos rri shumë gjatë, pasi i sëmuri nuk duron. Kur u sëmur një herë imam Ebu Hanifeja, i shkuan për vizite katër veta. Ata harruan se kishin shkuar për të vizituar një të sëmurë dhe ndenjen gjatë. Ebu Hanifeja kur pa se nuk po çoheshin, u tha: **“Çohuni se me shëroi Zoti”**.

Edukata me komshinjtë.

Profeti (a.s.) na mëson që të sillemi mire me komshinjtë. Nëse blejmë diçka për të ngrënë dhe na shohin komshinjtë është mire që t'u japim dhe atyre diçka prej saj.

Nga etika me komshinjtë është që nëse gatuan diçka të shijshme, t'u servirësh diçka prej saj edhe komshinjtë. Islami na ndalon që dhe murin e shtëpisë të mos e bëjmë me të lartë se ai i komshiut, veçse me lejen e tij.

Etika në xhami.

Islami na nxit që brenda xhamisë të sillemi mire, të mos e ngremë zërin, të mos i shqetësojmë njerëzit duke kaluar mes rreshtave etj. Nëse shikon dikë që vepron diçka që nuk lidhet me fenë, këshilloje me të bute jo ashpërsisht. Kur një i moshuar beri një veprim që nuk e përmbanin ligjet islame, një i ri që ndodhej aty pranë reagoi ashpërsisht ndaj këtij veprimi, duke i thënë që kjo nuk është prej Islamit. I moshuari iu përgjigj me fjalët: **“Mos valle fjalët e tua të ashpra, janë prej Islamit?!”**

Etika gjate ftesës në rrugën e Zotit

Dy nipërit e Profetit (a.s.), Hasani dhe Hyseni, një ditë panë një të moshuar që po merrte abdes gabimisht. Shkuan tek i moshuari dhe me të bute i thane: **“O xahxhai ynë, secili prej nesh, pretendon se merr abdes me mire se tjetri. Për këtë vendosem të marrim abdes në praninë tendë dhe ti të na gjykojë se cili prej nesh merr abdes siç duhet”**. Te dy filluan të marrin abdes njëllor dhe siç duhej. I moshuari kur i pa se si morën abdes, e kuptoi se ai nuk kishte ditur të merrte siç duhej dhe u tha: **“Ju të dy morët abdes njëllor dhe siç duhet, por unë nuk paskam ditur të marr abdes siç duhet”**. Një herë, teksa Profeti (a.s.) rrinte me shokët në xhami, vjen një banor i shkretëtirës dhe fillon të urinojë në një qoshe të xhamisë. Shokët e Profetit (a.s.) kur e panë, u revoltuan dhe u drejtuan drejt tij që ta ndalojnë. Profeti (a.s.) u tha që ta linin të qete deri sa të përfundonte dhe të hidhnin një kove ujë në vendin ku urinoi. Pasi përfundoi, iu afrova dhe me të bute i tha: **“Këto janë vende ku adhurohet Zoti dhe nuk është e pranueshme që të perdoren për të kryer nevojën”**.

Ebu Hanifeja kishte komshi një të ri, i cili çdo ditë pinte alkool deri sa dehej. Gjatë natës kur Ebu Hanifeja çohet të falej, djaloshi i dehur thërriste me të madhe: -“Me çuan dem, për Zotin, më çuan dem” - Ebu Hanifeja megjithëse zëri i tij natën e shqetësonte, e dinte se sikur t'i fliste në ato çaste nuk do të bënte dobi. Kjo gjendje vazhdoi derisa një

Etika islame

nate nuk e dëgjoi zërin e tij. Te nesërmen pyeti mbi djaloshin dhe i thanë se e kane burgosur, ngaqë e kishin kapur te dehur. Ebu Hanifeja shkoi ne polici dhe u kërkoi ta linin te lire. Meqë Ebu Hanifeja ishte person i njohur, e lanë te lire dhe ia dorëzuan atij. Ebu Hanifeja i dha një mushke për t'i hipur dhe te dy u nisën për ne shtëpi. Kur arritën, Ebu Hanifeja i tha: -"A te kemi çuar dem, o djalë?" "Jo, për Zotin, - ia ktheu djaloshi, - dhe te jap fjalën qe nuk do te veprojmë me si me parë".

Etika gjate bisedës me te tjerët.

Sot është bërë e zakonshme ndërprerja e fjalës se tjetrit. Islami këshillon qe ta lesh tjetrin deri sa ta përfundoje fjalën. Një jobesimtar erdhi te Profeti (a.s.) dhe i ofroi gjera tepër te ulëta, me qëllim qe te hiqte dore nga Feja Islame. Megjithëse ishin gjera tepër te ulëta, Profeti (a.s.) nuk ia ndërpreu fjalën, por e la te fliste deri sa përfundoi. Kur përfundoi e pyeti: -"A e mbarove fjalën tende, o Ebu Velid?" -"Po", -i tha. -"Atëherë me dëgjo mua", -i tha Profeti (a.s.) dhe i shprehu mendimin e tij.

Gjithashtu Islami i ndalon dy persona qe te bisedojnë me njeri-tjetrin me zë te ulet ne praninë e një te treti. Këtu hyn edhe nëse këta te dy flasin një gjuhe qe i treti nuk e kupton.

Dy myslimanë nga vendet arabe punonin ne një fabrike ne Angli. Me ta punonte dhe një grua angleze. Kur ishin vetëm, dy muslimanët bisedonin arabisht, por sa fillonte te afrohej kolegia e tyre angleze, fillonin te bisedonin anglisht. Kjo fillon t'i beje përshtypje koleges se tyre dhe një ditë i pyet: -"Perse kur jeni vetëm ju te dy flisni arabisht dhe sapo te me shihni mua te afrohem, filloni te bisedoni anglisht?" -"Feja jone, - i thonë, - na e ndalon te flasim ne një gjuhe qe një i treti nuk e kupton, me qëllim qe të mos fyhet dhe te mos mendoje se po flasim për të". - Gruaja shprehu habi mbi edukatën islame dhe pas gjashte muajsh pranon Islamin. Pasi behet muslimane thotë se gjeja e pare qe me beri përshtypje ne Fenë Islame, ishte edukata.

Një njeriu te ditur, teksa po ecte me djalin e tij, i doli para një qen. Djali i foli qenit duke i thënë: -"Largohu, o qen bir qeni!" - Babai i tij i tha: -"Mos thuaj me kështu, o biri im". -"Po perse, o baba, -i tha djali, - a nuk është qen bir qeni?" -"O djali im, -i tha babai, - ti nuk i the qen bir qeni për te treguar se ashtu është, por për ta përbuzur dhe një gjë e tille nuk duhet te dale me nga goja jote".

Etika ne te folur është qe te mos prekësh ndjenjat e dikujt tjetër. Nëse dikush vepronte diçka jo të mire, Profeti (a.s.) nuk ia përmendte kurrë emrin, por thoshte: "Disa prej jush veprojnë kështu... dhe kjo nuk lejohet". Pasi Jusufi (a.s.) takohet me babanë dhe vëllezërit, i thotë babait: "O babai im, kjo është domethënia e ëndrrës time te mëparshme, te cilën Zoti e beri realitet dhe mua me dha mirësi kur me nxori nga burgu dhe juve u solli nga fshati, pasi djalli kishte mbjelle armiqësi mes meje dhe vëllezërve te mi". Ne fakt, djalli pati mbjelle armiqësi vetëm te vëllezërit e Jusufit dhe jo tek ai, por e futi edhe veten e tij me qëllim qe te mos i ofendoje vëllezërit.

Edukata me njerëzit qe kane pozite te larte.

Kjo është nga porositë dhe tradita e Profetit Muhamed (a.s.) qe kur u dërgoi letër perandorëve me te mëdhenj te asaj kohe për t'i ftuar ne Islam, e niste letrën me fjalë qe tregonin edukatë dhe respekt, si p.sh.: "Nga Muhamedi, i Dërguari i Zotit, drejtuar Herakliut, te madhit te Romës!" "Nga Muhamedi, i Dërguari i Zotit, drejtuar Kistras, te madhit te Persisë!"

Edukata me ata qe te kane bere mire, mësuesit etj.

Abbasin një dite e pyeti dikush: "A ti je më i madh, apo Profeti?" Abbasi ishte me i madh ne moshe se Profeti (a.s.), por qe fjala te mos merrte kuptim tjetër, tha: "Profeti (a.s.) është me i madh se unë, por unë kam lindur para tij". Kur Profeti (a.s.) dhe Ebu Bekri arritën ne Medine, banoret e Medines nuk e njihnin se cili prej tyre ishte Profeti. Njerëzit qe po i prisnin kujtuan se Ebu Bekri ishte Profeti, kështu iu afruan duke e respektuar. Ebu Bekri nuk u tha qe nuk ishte ai Profeti, por mori mantelin qe kishte hedhur krahëve dhe filloi t'i beje fresk Profetit (a.s.). Atëherë njerëzit e kuptuan se kush ishte Profeti a.s. Imam Shafiu thoshte: "Kur jam me mësuesin tim, nuk shfletoj as fletët e librit, se mos e shqetësoj, nuk pi as ujë ne praninë e tij, nga respekti për të".

Edukata gjate përcjelljes se te vdekurit.

Profeti (a.s.) thotë: "Zoti e pelqen heshtjen ne tre gjera: ...dhe ne përcjelljen e te vdekurit".

Për sa përmendem me sipër, vlen te themi se megjithëse edukata është diçka e kërkuar, nuk duhet të tepruhet me të, por gjithçka te jete e sinqerte dhe jo e shoqëruar me lajka dhe për sy e faqe të te tjerëve. Imam Shafiu thotë: "Njerëzit më të rëndë (të mërzitshëm) për mua janë ata që shtiren dhe më duhet të shtirem me ta. Kurse njerëzit më të dashur janë ata që kur jam me ta, ndihem sikur jam vetëm.

Përzgjedhi: Gazjon Rusi

DIPLOMACIA NDERKOMBETARE PO REALIZON COPETIMIN E KOSOVES



Në të gjitha planet dhe përgaditjen e saj, për ta çuar Kosovën drejt statusit të saj, me pikësynimin final, pavarësinë e saj, diplomacia perendimore e ka përjashtuar, pa mëdyshje, idenë e ndarjes territorjale te Kosovës. Por, ngjarjet precipituan me shpejtësi në dëm të çështjes së Kosovës, ku përcaktuese shikohet dora e ashpër e Rusisë së presidentit Putin, miq të vjetër të Serbisë dhe të politikës së saj antishqiptare. E vërteta është se diplomacia perendimore, varjantin e ndarjes së Kosovës, pa tjetër që e ka pasë nën tavolinë, e gatshme për ta hedhë mbi tavolinë, kur ta shihet se këtij plani ogurzi per Kosovën i kishte ardhë dita.

Për fat të keq, duket se ne po jetojmë pikërisht ditën, kur diplomacia ndërkombëtare ka hedhur mbi tavolinë planin e rrezikshëm për ndarjen e territorit të Kosovës. Zëri i pare, që u ndigjua për të ndarë Kosovën, ishte ministri i jashtëm frances Kushner, emër i njohur ky për kosovarët si një filo serb, kur ishte në drejtim të faktorit ndërkombëtar në Kosovë. Eshtë ky Kushner që, pasi vizitoi Beogradin, e pranoi ndarjen e Kosovës, në se palët janë dakort. . . Menjëherë pas tij e ngrii rërin ambasadori britanik në Beograd dhe, në këtë unison zërash kundër Kosovës, u bashkua, për fat të keq, edhe një analist i njohur amerikan.

Deklarata e axhensise Rojter se diplomatët perendimorë po diskutojnë për ndarjen e Kosovës, tregoi se Kushner kishte shkuar me porosi në Beograd dhe, ato që tha, nuk i kishte nga vetja. . Në mediat e shkruara dhe vizive ndërkombëtare po qarkullon lajmi se plani për ndarjen e Kosovës është ide e vjetër serbe dhe ruse, duke na bërë të dyshojmë në sinqeritetin e miqësisë për Kosovëv që servir diplomacia perendimore në axhentën e saj për të zgjidhë statusin final të Kosovës.

Politikanja e njohur evropjane, Doris Spak, i kujton Perëndimit se Kosova nuk duhet të mbetet peng i Rusise dhe i interesave të saj në Ballkan. , duke i shtuar kësaj deklarate edhe atë që tha Oli Reh, i cili theksoi se Evropa do ta paguaj shumë shtrenjtë

dështimin e pavarësisë së Kosovës. Por, duket se gjerat janë rrokullisur me shpejtësi në dëm të Kosovës, gjë që e ka detyruar Veton Surrinin ta gjejë më në fund vehten dhe të deklarojë, permes një letre për anëtarët e ekipit negociator të Kosovës, se

KA VDEKUR PAVARESIA E KOSOVES

Duket se faktori ndërkombëtar, që po dërgon në tryezën e bisedimeve pa shpresë serbët dhe kosovarët, ka bërë llogari që në këto bisedime të përdoret në fund karta e ndarjes së Kosovës e cla, nga një alternative për diskutim, të kthehet në një alternative të imponuar për palët që do të ulen nesër në tavolinën e bisedimeve.

Tashti po shihet qartë se Perëndimi e ka hequr nga axhenta e tij planin A për Statusin e Kosovës dhe ka hedhur mbi tavolinë planin e rrezikshëm B, i cili kërkon ndarjen e territorit të Kosovës. , akt ky që nuk dihet se çfarë reaksioni zingjir do të sjelle.

Por, elementët e pare të reagimit kanë filluar të duken krejt haptas. kur kryeministri kosovar akuzoi ashpër dhe publikisht diplomacinë ndërkombëtare se Këshilli i Sigurimit po e zvarrit çështjen e statusit të Kosovës, duke e errësuar rrugën dhe kohën e zgjidhjes së tij, duke lënë të nënkuptohet se Kosova do të jetë një kockë e forte për dilomacinë perendimore që po përpiqet të realizojë planet e saj në dëm të Kosovës.

Deklaratat e politikanëve kosovarë ecin edhe më përpara, kur kryeministri deklaroi se do të zgjedhim rrugën më të vështirë për të realizuar Pavaresinë, deklarim që ndiqet nga prononcimi i Albin Kurtit se populli i Kosovës do të rebelohet kundër projekteve të të huajve që janë kundër Kosovës dhe se zgjidhja, që po përgadit Perëndimi, as nuk na pëlqen, as nuk na duhet.

Në një linjë me problemin që po trajtojmë, gazetarja e njohur kosovare, Alma Lamaj, do të bëjë të njohur për opinjonin

publik se diplomacia ndërkombëtare po punon intensivisht për ndarjen e Kosovës, duke dërguar agentët e saj në terren për të përcaktuar vijat e ndarjes të cilat, po tjetër që do t, i japin hartës së Kosovës pamjen e lekurës së leopardit, të mbushur me njolla të pafundme.

Analistët e njohur parashikojnë se një pavarësi për Kosovën do të sjellë reagimin e komunave serbe, që do të shpallin një

pavarësi territorjale, duke realizuar lidhje paralele ekonomike dhe politike me njëra tjetrën që pa tjetër do të sjellin edhe lidhje vertikale me Beogradin, duke e çorjentuuar shtetit e ardhshëm të Kosovës. Analistët flasin edhe për një diplomaci imponuese për palët që

do të ulen në tavolinë për bisedime, duke u hedhur në tavolinë edhe mundësi për shkëmbime terroresh, për t, i çuar palët drejt një kompromisi të mundshëm. Por, lëvizja e kufijve, në emër të shkëmbimeve të terroreve, na kujton kryemistrin kosovar qe ka deklaruar se po filloi lëvizja e kufijve, askush nuk mund të dijë se ku do të lëvizin dhe kur do të ndalet lëvizja e tyre.

Ngjarjet, qëne pa tjetër që do të shohim më vonë, do të tregojnë se cilat kanë qenë piketat e vërteta të diplomacisë perendimore për çështjen e Kosovës dhe sa ia kanë pasë me hile Kosovës në drejtim të realizimit të aspiratave të saj për Pavarësi.

SELIM GOKAJ
Shkoder, me 2korrik 2007

KONFERENCA ISLAMIKE ESHTË NJEZERI PËR PAVARËSINË E KOSOVES



Në këto momente të vështira për fatin e Pavarësisë së Kosovës, politika kosovare po bën të pamundurën që të sigurojë mbështetje nga faktori ndërkombëtar, qe ajo të dale e fituar në betejën me Serbine dhe aleatët e saj të shumtë me Rusinë në ballë.

Ne kuadrin e këtyre lëvizjeve diplomatike, anëtar i grupit negociator të Kosovës, Veton Surroi, bëri një vizitë në Malajzi, në këtë vend musliman, për të siguruar mbështetje për çështjen e Pavarësisë së Kosovës. Por, udhëtimi, që Surroi bëri nga Malajzia drej Pakistanit, ku po bëhej mbledhja e vendeve të Konferencës Islamike, nuk pati sukses sepse, presidenti i Kosovës, Sejdiu,

e ktheu Veton Surroi nga rruga duke na kujtuar me këtë veprim paraardhës të tij të LDK që kishte alergji për fenë islame sa që edhe u konvertua në fenë e krishterë, gjithmonë sipas intervistave të dhëna në media nga ai vetë. Por, duket se për presidentin Sejdiu dhe ata që janë pas tij, më rendësi ka elementi fetar islam me synimin që të rrijnë larg tij, se 57 votat e vendeve muslimane që do të jenë të gatshme në OKB, për të finalizuar aprovimin e Kosovës si shtet i pavarur.

Eshtë për të ardhur keq qe tabori me analistë në mediat shqiptare, qe janë në një vale me presidentin e Kosovës për qëndruar larg vendeve muslimane, nuk është i vogël. . Atij i është vënë në krye një emër i njohur antimusliman për të cilin elementi fetar

është përcaktues për Pavarësinë e Kosovës, pa harruar edhe hallin e tij të madh fetar, se religjoni, të cilit i takon, do të thellojë minorancën kur Kosova

e pavarur do t, i bashkangjiten Shqiperise. Pa tjetër ka edhe të tjerë si Ardian Ndreca qe edhe ato e kanë të vështirë të flejnë gjumë me një Kosovë të pavarur.

Por, ky tabor i egër antimusliman në media dhe në politikën shqiptare, nuk duhet të harrojnë se përpjekjet e tyre për të mohuar rendësinë e elementit musliman në Kosove është vetëm një përpjekje qyqare, sepse në Kosovë muslimanët dominojnë bindshëm me mbi 90% të popullsisë. Ajo që të shqetëson është se ato, që po i kundërvihen përkrahjes së vendeve muslimane për pavarësinë e Kosovës, janë zëra dhe përpjekje kundër Pavarësisë së Kosovës. Ato analistë qe po i bëjnë këto lëvizje të rrezikshme e dine këtë gjë. Kurse ato që i shohin këto lëvje ka mundësi që të mos i dine, ose të shtiren si të tillë

Diplomacia ndërkombëtare njeh raste të panumurta, kur shtete të fuqishme të krishtera kane kërkuar mbështetjen e vendeve muslimane për të realizuar interesat e tyre

politike, ekonomike ose ideologjike.

Prandaj, përkrahja dhe simpatia e vendeve muslimane në të gjithë botën për Kosovën, që ka një magjorancë të theksuar muslimane, është e natyrshme dhe shumë e dobishme, sidomos në këto momente për

Statusin e Kosovës.

Ardian Ndreca me kompaninë e vet penalizoi edhe pjesëmarrjen e z. Edit Harxhi në punimet e Konferencës Islamike në Pakistan, duke vazhduar tashmë që këto të jenë pjesë e zërave që janë kundër pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë konferencë. Duket se veprimi i ish-presidentit Berisha në vitin 1992 ishte një veprim i zgjuar politik, sepse, ndihmat që Shqipëria dhe Kosova kanë marrë në momentet e tyre të vështira nga vendet muslimane, kanë qenë të njëjta rendësie të vaçantë duke treguar kështu se me vendet muslimane na lidhin ura të vjetra dhe ura të reja, të cilat nuk mund t, shkatërrojnë Ardian Ndreca dhe prapavija që ai, me të tjerë, përfaqësojnë sot në histerinë antimuslimane të mediave shqiptare.

Konferenca e Vendeve Islamike i mbylli punimet e saj në Islamabad të Pakistanit. Ne dokumentin e saj final, Konferenca e Vendeve Islamike theksoi njezëri se vendet muslimane mbështesin pa rezerva Pavarësinë e Kosovës.

Për fat të keq, një pamje tjetër ka harta e Evropës në mbështetje të Pavarësisë së Kosovës. Tashmë, krey haptas, po

e çojnë kartonin kundër Pavarësisë së Kosovës shtete të tilla si; Greqia, Romania, Spanja dhe pa tjetër shtete të tjera, qe mediat shqiptare, nga halli, e kanë të vështirë t, i artikullojnë Fakti është se këto shtete e kanë treguar vehten se janë angazhuar direkt në veprime kundër muslimanëve. . Në Srebrenicë, një brigade greke masakroi muslimanët e Bosnjes. Policet rumunë të UMNİKUT ishin ato që qëlluan pa mëshirë dhe vranë aktivistët e Lëvizjes së

Vetvendosjes në demonstratat e fundit në Kosove. Kurse, Spanja e ka njollën e krimit për shfarosjen dhe vrasjen e miljonave muslimanë, në kuadrin e kthimit me dhunë të muslimanëve spanjolle në të krishterë. Prandaj, veprimet e këtyre shteteve dhe të tjerë si këto kundër Pavarësisë së Kosovës, ka një prapavije antimuslimane të theksuar.

Sot, harta e Evropës, me pamjen e një spektr të lekurës së leopardit për qëndrimin ndaj pavarësisë së Kosovës, është në një antitezë të thellë me sloganin tashmë të njohur i cili është kthyer në një shpresë për të gjithë shqiptarët i cili është : “VETEM DREJT EVROPES NE DO TE SHKOJME”

H. Vehbi Dani
Shkodër, me 29 korrik 2007

Rabini Kryesor në Dagestan pranoi Islamin



Përqaftimi i Islamit nga ana e rabinit kryesor në Dagestan shkaktoi panik dhe krizë në mesin e radhëve të çifutëve në Dagestan. Kjo nuk ndodhi për shkak se ky është rabini i dytë i cili përqafton Islamin, por për shkak se çifutët ngelën pa rabin në

mesin e tyre. Gazeta çifute "Mearif" më 05.09.2002 bën të ditur se gjatë intervistës me rabinin ai kishte thënë se një zonjë muslimane kishte kërkuar nga ai që ta lexojë me vëmendje Teuratin dhe Kur'anin Fisnik dhe se vetë leximi i Kur'anit e kishte iniciuar atë që ta pranojë Islamin, si dhe se prej asaj kohe ai është duke qëndruar në një ndër xhamitë më të mëdha të Dagestanit. Sipas disa të dhënave bëhet e ditur se rabini më i madh i Dagestanit është me prejardhje ruse, se është diplomuar në Akademinë për studime fetare çifute në Moskë dhe se punën e tij në Dagestan e ka filluar prej vitit 1997 në qytetin Mahaçkala. Gazeta, sipas burimeve të përfaqësuesit të po kësaj agjencie, bën të ditur se situata ishte krejt normale para se të pranonte rabini Islamin, por pasi që ai pranoi Islamin u shkaktua problem, gjë që i detyroi çifutët ta bojkotojnë atë dhe në vend të tij të marrin një të ri prej çifutëve të Moskës për t'i kryer ritualet në sinagogë. Sipas deklaratës së një qytetari musliman të Dagestanit, bëhet e ditur se ky nuk është rabini i parë që pranoi Islamin, ngase edhe në vitin 1999 një rabin kishte pranuar Islamin. Informatat tregojnë se çifutët kanë ardhur në Dagestan në shekullin 14 dhe se

Rusia paralajmëron se në 2050 muslimanet do të jene shumice në Rusi

Nga mesi i këtij shekulli në Rusinë ortodokse do të mbizotërojnë muslimanët. Federata Ruse po përjeton një transformim të madh demografik, sepse numuri i popullsisë po bie 700 mijë në vit, në një kohë që numuri i ëopullsisë muslimane është rritur me 4% në vit.

Sipas llogarisë së OKB popullsia e Rusisë që sot është 140 milion mund të pakësohet me një të tretën deri në vitin 2050. Shumë ekspertë pranojnë se një kombinim i rpnies së lindjeve tek rusët etnikë dhe shtimi i lindjeve tek popullsia muslimane mund të çojë tek një shumicë muslimane në vitin 2050 në Rusi. Kjo pasojë vjen nga se tek rusët ka një nivel të lartë vdekshmërie tek moshë 18 deri në 55.

Meskujt ruse po vdesin me shpejtësi nga alkoolizmi sëmundjet ,aksidentet industriale që janë në nivele shumë të larta në ditët e sotme. Këto tregues bëjnë që numuri i rusëve etnikë të bjerë në më shumë se 1 milion në vit. Muslimanët në Rusi jetojnë pranë lumit Vollga dhe në Kaukazin verior, ku ato përpiqen të jetojnë larg veseve dhe treguesve të tjerë të cilët po degradojnë shoqërinë njerëzore.

Përgaditi Ditmir Gokaj
Shkodër me 4 korrik 2007


ZOTERIA I LUFTES

Para nente vitesh, gazeta angleze "Guardian" zbuloi nje histori tronditese, te harruar nga lufterat ballkanike, ku tregohej se ne nje qytet te vogel boshnjak ishin vrare me mijra civile muslimane dhe trupat e tyre ishin hedhur nga ura e vjeter e ketij qyteti. Te mbijetuarit nga kjo masaker fajesuan per keto krime nje emer pak te njohur ne opinjonin publik, Milan Lukic. Qyteti boshnjak i Vishegradit ka zene vend ne luginen e lumit Drina, ne nje pozicion te mrekullueshem te rrjelljes se tij, atje, ku shkembinte ndahen per t'i lene vend nje lugine te gjelbert.

Per shekuj me rralle, megjithese lufterat i rane kryq e terthor Drinas, Vishegradi kishte mbetur nje qytet me dy te tretat muslimane boshnjake, kurse nje e tretat ishin serbe boshnjake. Te dy bashkesite u binjakezuan dhe pak kush e vinte ujin ne zjarr se c, ishte njeri, apo tjetri. Por, ne pranveren e vitit 1992, nga serbet boshnjake u derdh nje dhune e papare ndaj fqinjëve te tyre muslimane, qe u pa nga sulmet e pergjakshme qe perfshine lugine e Drinos dhe te gjithë Bosnjen. Vishegradi eshte nje nga emrat e harruar, kurse Srebrenica jeton ne histori. Vishegradi ka qene nje histori e dhimshme, sepse aty, nate per nate, silleshin me kamione civile muslimane dhe mbi ta eshte bere nje masaker e vertete, duke i therur me thika, ose duke i vrare me arme dhe pastaj ato jene hedhur ne lumin e Drinos, duke e kthyr ujin e tij nga blu ne te kuq. Ne kasaphanen mbi ure, disa u grumbulluan neper shtepi dhe aty u dogjen te gjalle se bashku me femije gra e pleq. Vishegradi ka qene stacioni i njerit nga kampet me te famshem te perdhunimit te grave e vajzave boshnjake nga kriminelet serbe. Ne nje shtepi te quajtur Vilina Vllas, grate dhe vajzat muslimane jane perdhunuar masivisht duke i cuar keto viktima deri ne cmenduri dhe ne vetvrasje. Keto masakra ishin zbatim i urdherave te udheheqesve serboboshnjake Radovan Karaxhic dhe Ratko Mlladic, qe sot kerkohen per t'u gjykuar per krime lufte kunder njerezimit. Por, te gjithë te mbijetuarit nga masakrat ne qytetin e Vishegradit, deshmojne se masakrat dhe mizorite ne kete hapësire boshnjake mbajne direkt, ose indirekt damken e nje njeriut, ate te Milam Lukic.

Pas 7 vjet arratie nga gjykata e krimeve te luftes ne Hage, ai u arrestua ne apartamentin e tij ne Argjentine. Per shume njerez qe kane perjetuar ate qe ndodhi ne Bosnje. Lukic eshte njeriu me duar me te pergjakura me gjakun e muslimaneve ne Bosnje. Per kete kriminel, ky arrestim i jep fund nje nje periudhe 13 vjecare te nje gangsteri dhe te nje kriminele qe krenohet se ka pase mbrojtjen e shtetit serb dhe te rrjetit qe ka mbrojtur Karaxhicin, mbrojtje qe e ka humbur pastaj.

Mizoriite e vitit 1992, qe e lane Vishegradin pa 14 mije muslimane, kishte mbetur nje sekret te cilin e dinin vetem ato qe e perjetuan ate masaker. Para se emri i Lukicit te behej i njohur ne publik, u deshën te kalonin shume vite. Ne fillim te viteve 1996, gazeta "Guardian" u ftua te takonte disa te mbijetuar nga pushtimi serb i enklavave muslimane te Srebrenices dhe te Zhepa-s, te cilet ishin evakuuar ne nje spital te semundjeve mendore ne Dublin. I mbijetuari, Jasmin, qe ne vitin 1992 kishte ikur nga Vishegradi ne Zhepa,



tregon se atij i kishin ngarkuar detyren qe te terhiqte kufomat e enjtura nga lumenjte Drina dhe Zhepa, qe pastaj ato te varroseshin. Se bashku me nje burra te quajtur Mersud, ai sillte trupat me nje varke te vogel per t'i shpetuar snajperve serbe qe donin te mbulonin krimet e tyre. Ne kemi varrosur 180 vete. Pasi u muar takim me Mersudin, ai i konfirmoi ato qe kishte thene Jasmini duke shtuar se e njihte shume mire Lukicin. cili ne kohe paqeje "Ishte dukur nje djale i mire". Me vone doli ne drite nje fakt, sipas te cilit, kufomat po bllokoni tubacionet e diges dhe duhej qe te ndalej rrjellja e tyre neper lume per arsye e me siperme. Deshmitaret e ketyre masakrave gjurmuan neper te gjithë Bosnjen dhe ne Evrope. Te gjithë deshmitaret kujtonin nje veture te kuqe qe Lukic e kishte per merak dhe e kishte bere prone te veten, sepse te zotin e kishte vrare. Deshmitarja Fehida kishte pare Lukicin me veturen e tij e cila ndiqej nga kamione qe arrinin mbi ure dhe pastaj i hidhnin njerezit ne lume duke i qelluar pastaj me arme. Deshmitarja Hasema tregon e tmerruar; "I pashe

ata te vendosnin nenen dhe motren time mbi paretet e ures. i ndigjoja grate qe ulerinin dhe burrat qe qeshnin pasi i qelluan, duke e kthyr ujin, ku rane, ne ngjyre te kuqe.

Po keshtu, deshmitarja Zehra, me duart dhe fetyren e deformuar nga zjarri, kujton vehten duke ikur nga nje shtepi ne Bikavac ku ishin kycur 70 persona qe u dogjen te gjalle, masaker qe u be nga Lukici dhe te tjere.

Ne te vertete, nuk kane mbetur shume muslimane per te deshmuar per genocidin e asaj

pranvere dhe per ato qe ndodhen me vone. Nje ushtar musliman kujton Lukicin duke i kujtuar turmes se te burgosurve se ato qe jane nga Vishegradi te dalin nj hap perpara rreshtit, duke pergaditur keshtu vdekjen e tyre. Milan Lukic u akzua nga Haga ne vitin 1998 per shfarosjen e nje numuri te konsiderueshem civilesh muslimane boshnjake, duke perfshire gra pleq dhe femije, veprime te kryera ne bashkepunim me shume kriminele te tjere.

Per vite me rralle, serbet e Bosnjes dhe serbet e Serbise, nuk treguan deshire per te dorezuar Lukicin. Ai shihej rreth Vishegradit dhe neper Serbi, ku angazhohej ne veprimtari kriminale dhe u arrestua tri here, por me ndihmen e miqve munde te shpetonte. Ishte rrjeti Preventiva, nje organizate e armatosur qe mbronte Karaxhicin dhe Lukicin. Vete ky kriminel mbrohej dhe nga Stredan Lukic, qe ishte minister ne qeverine serbe, por qe me vone u dergua ne Hage, i akuzuar per krime lufte ne Bosnje.

Por, Lukic u perlesh me rojet e Karaxhicit dhe i pasigurte per mbrojtjen e tij, hyri ne tratativa me Hagen per t'u dorezuar, por nuk u paraqit ne takimet e planifikuara. Ne shtator 2003, nje gjykate serbe e denoi me 20 vjet burg per vrasjen e 16

muslimaneve te marre nga nje autobus ne linjen Serbi- Bosnje ne vitin 2003, vendim ky i marre nen presionin nderkombetar.

Qe nga prilli i vitit 2004, Lukic ishte zhukur nga Vishegradi dhe nga Serbia duke dale me vone ne siperfaqe me deklarata ku betohej qe Mlladici do te mbetej idhulli dhe heroi i vertete i tij dhe se Karaxhici do te jete udheheqesi i popullit te tij.

Gjykatesve argjentine u tha se kishte hyre ne kete vend me nje pasaporte fallco dhe se ishte pergaditur per t'u dorezuar ne Hage por kishte frike njerezit e Karaxhicit qe mund ta elemionin per sekretet qe ai dinte. Sipas tij, shume gjera kane ndodhur gjate luftes dhe ka shume njerez qe nuk duan qe keto te behen te njohura. Pra me mire., sipas Lukicit, te jesh nje njeri qe nuk ben ze.

*Pergatiti per botim
Ismet Zaganjori*

DAVE APO POLITIKE

Besimtarët muslimanë ne Kuranin Famëlarte kanë mësuar dhe vazhdojnë të mësojnë për ngjarje që fillojnë nga perhistoria dhe me herët, ku spikat ardhja e pandërprerë e profetëve që fillojnë; me Ademin a. s. dhe ndalojnë me profetin e fundit, . Muhamedin a. s., të cilët Allahu Famëlarte ua dërgoi njerëzimit si udhëzim që ato të largoheshin nga rruga e gabuar dhe të ktheheshin tek rruga e Allahut Famëlartë, që është rruga e vetme e shpëtimit për mbarë njerëzimin. Misioni i këtyre profetëve ishte që njerëzimi të bindej në egzistencën e Allahut Famëlartë

Profeti ynë, Muhamedi a. s., qe nga fillimi i misionit të tij profetik dhe deri te Hytbja e Lamtumirës, nuk beri politike, por beri vetem dave e cila u pa edhe te letrat që u dergonte mbretërve te popujve që i luteshin idhujve, duke u kerkuar qe ato të besonin vetëm

një zot të vetëm, Allahun xh. sh.. Shumë qartë u pa daveja e Profetit dhe mëshira e tij, kur ai hyri triumfues ne Mekë ku

qëndrimi që mbajti ndaj idhujtarve ishte mëshirues dhe thirrës në fenë e Allahut Famëlartë

Porosinë për dave na e jep edhe Kurani Famëlartë permes sures (El Huxhuratë) "O besimtare! Mos beni azgjë para se te orjentoheni ne udhëzimet e zotit dhe të dërguarit të tij. Keni kujdes Allahun, se me të vërtetë Allahu i ndigjon të gjitha dhe i di të gjitha.

Per besimtarin dhe portretin e tij, Allahu Famëlartë na flet në shumë ajete. Në një ajet AI thotë; "Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të dërguarit të tij e mandej nuk dyshuan edhe për hir të Allahut luftuan me pasuri dhe jetën e tyre. Të tillë janë ato të vërtetët (El Huxhura).. Islami është një rrugë e drejtë që nk pranon paralele dhe devijine. Ata, që përpigjen t, i ndryshojnë drejtim, ata kane marrë rrugën e devijimit nga rruga islame.

Daveja ka vlera te larta ne këtë dynja dhe po kaq vlera edhe ne Ahiret, sepse është daveja qe i thërret njerëzit në rrugën e shpëtimit nga e keqja e dynjallekut, duke i drejtuar ata ne rrugën e pervetësimit të fesë islame., sepse është e vetmja rrugë qe

besimtarin e çon tek kënaqesia dhe mëshira e Allahut Famëlartë duke fituar njëkohësisht edhe Ahiretin.

Eshte politika ajo qe mbron interesat e kësaj jete, duke i dhëne përparësi kësaj jete, që besimtarët t, i largojë nga besimi në Allahun Famëlartë.

Kurani Famëlartë u ka berë portretin në suren Ibrahim atyre qe jetën e kësaj bote e kanë përparësi duke thenë;"Ata që i japin përparësi jetës së kësaj bote ndaj botës tjetër, pengojnë nga rruga e Allahut dhe kërkojnë shtrembërimin e saj. Të tillë qartas janë në humje'

Sot, ne kemi shumë nevojë të bëjmë dave, qe ata, qe kanë rënë ne mesin e së keqes, t, i drejtojmë drejt së mires që është përqafimi i fesë islame si fe hyjnore e shpallur nga Allahu Famëlartë. Po te shikojmë me kujdes politikën e sotme, do të shohim se ajo po bën hapa të rrezikshme qe te degjenerojë moralin e shoqërisë, duke rrezikuar edhe moraln e besimtarëve muslimanë, dukuri këto që ne i shohim në përmasa shumë të rrezikshme për besimtarët muslimanë në të gjithë hapësirat shqiptare.

Sidomos, permes mediave, politika po sulmon

ashpër shoqërinë njerëzore, duke investuar shuma kolosale për t, i drejtuar njerëzit drejt largimit të fesë islame, që e s h t e e d h e humbja e vërtete për besimtarët muslimanë. Eshtë kjo media që sot po i bën jehonë dërgimit të trupave shqiptare ne vatrat e nxehta të luftës, ku vriten muslimanë, në emër të një lufte të pa drejtë, ku

vrasja e muslimaneve bëhet në emër të një terrorizmi imagjinar, që nuk është gjë tjetër veçse luftë kundër muslimanëve në shkallë botërore.

Politika shqiptare është ajo që po pengon ndërtimin e xhamisë ne Tiranë, duke i lënë besimtarët muslimanë të falen në trotuare, në një kohë që muslimanët në Tiranë posedojnë prona për të ndertuar disa xhami.

Janë mediat politike në Shqipëri qe i bëjnë jehone lajmeve për përalla me Bin Ladene dhe Alkaida.. Për atentate te mbetura në tentativë dhe shumë truke të tjera që sulmojnë fenë islame dhe besimtarët muslimanë në të gjithë botën.

Kur presidenti Bush pohoi se Shqipëria është një vend musliman, politika shqiptare sulmoi me të gjitha mjetet ketë pohim te

z. Bush që ia rrënoi planet e kësaj politike për të mohuar një realitet të pamohueshëm.

Por, Allahu Famëlartë ka udhezuar muslimane qe të vërtetën e kalojnë ne media me guxim dhe



trimëri, duke demaskuar perpjekjet e politikës për të ulë vlerat e muslimanëve në Shqipëri e më gjërë, Në këtë drejtim, spikat analisti Abdi Baleta, qe permes gazetes Rimëkëmja dhe botimit te nje serie librash, e ka demaskuar islamofobinë qe ka kanë shpërthyer media kombëtare dhe ajo ndërkombëtare.

Ta njohësh dhe ta kuptosh islamin nuk është mjaftueshme për një besimtar. Besimtari duhet të jetojë dhe të ecë me moton;

"Zoti ynë është Allahu dhe Allahu është qëllimi ynë.

Eshtë pikërisht kjo moto që të largon nga çdo e keqe dhe te drejton vetëm nga e mira, e cila është mirësia dhe shpërblimi që ne do të marrim për aq kohë sa ne do të jemi në rrugën e Allahut Famëlartë

KASEM ZYLJA
Shkoder, me 2 korrik 2007

EDI RAMA PER SALI BERISHEN

Gjate turneut qe po ben neper selite e PS, per te pergaditur zgjedhjet e parakohshme,, kryetari I PS, Edi Rama, sulmoi si zakonish, te parin kryeministrin shqiptar, Sali Berisha, duke adresuar drejt tij ato qe ne I quajme sulme te rralles.

Kryetari I PS deklaroi se skandali me I madh I Berishes eshte shitja e Telekomit dhe ndertimi I rruges Durres Kukes. Nuk dihet perse I eshte prishur gjumi Edi Rames qe Telekomit do te jete ne duar te nje firme turke , e cila ka vendosur te ndihmoje klientelen shqiptare te Telekomit me cmime shume te ulta per telefonine celulare dhe ate fikse. Duket se ai po shqetesohet se do ta pesojne kompanite greke qe mund te marrin valixhet ,sepse spekulimi dhe grabitja e shqiptarve tashti po merr fund. Mos eshte ne ortaki Edi Rama me keto firma te telefonise celulare qe po na zhvasin xhepat? Nuk I dihet. Edhe mund te jete e vertete ,sepse grykesia per t,u pasuruar nuk ka kufi.

Por, shqetesues eshte shqetesimi I Edi Rames per investimet e qeverise se Sali Berishes, ne bashkepunim me donatore te huaj , per te lidhe

Shqiperine me nje tjetër hapësire shqiptare, qe eshte Kosova. Nuk dihet sakte perse afrimi me prane i Kosoves me token Ame e ben liderin e socialisteve te shkumezoje ne ekran kunder ndertimit te kesaj artereje jetike per fuqizimin ekonomik dhe politik te Shqiperise.Perse valle t,I kete kaq frike kosovaret qe do te hyjne ne Atdhen e tyre me rehat dhe me komode, me nje rruge me parametra te larte sigurie e qarkullimi?

Ne bejme hamendje per keto deklarata misterioze te Edi Rames, sepse te verteten e di vetem ai. Por, per fat te mire, edhe dime pak , perse Telekomit ne duart e turqve dhe rruga Durres Kukes qe do te mbushet me kosovare, te cilet do te udhetojne drejt Shqiperise, e ka bere liderin e socialisteve, Edi Ramen, e flase me vehte

SELIM GOKAJ
Shkoder, me 14 korrik 2007

Jeta dhe veprimtaria e Jusuf Efendi Tabakut



Dita 9 Shkurt 2007 do ta pasuroje edhe me tej historikun e shkollës 9 vjecare të Ajasmes, hapur që në fillimet e arsimit tone kombëtar, në vitin 1917, me drejtues të parë Musa Tabakun, një ndër mesuesit veterane të Shkodrës. Pikerisht këte dite, nxenesit dhe kolektivi i mesuesve të shkollës, së bashku me banorët autoktone të lagjes, përjetuan castë ngazellimi të vecantë, sepse shkollës së tyre, në prani të autoriteve vendore dhe të deputeteve të qytetit, iu vu emri i një personaliteti të shquar, ai i Jusuf Tabakut. Para zbulimit të pllakes së mermerte u shpaloj jeta dhe vepra e ketij biri të rrallë të lagjes dhe të mbare qytetit.

Jeta e Jusuf Tabakut ishte një jetë e shtrire në tre shekuj, sepse u lind në fund të shekullit XVIII, jetoi gjatë gjithë shekullit XIX dhe vdiq në fillimet e shekullit XX. Konkretisht u lind në vitin 1797 dhe vdiq në një moshe të thyer, 107 vjecare, më 2 Korrik 1902. Ai përjetoi periudhat e fuqizimit të Pashallekut të Shkodrës nën Bushatllinjte. Keshtu Jusuf E. Tabaku jetoi dhe veprroi në kushtet e rritjes së veprimtarisë ekonomike, shoqërore e politike të vendit tone, e posacerisht të Shkodrës.

Jusuf Tabaku lindi dhe u rrit në lagjen Tabake, një nga lagjet më të vjetra, më të pasura e të fuqishme të qytetit tone. Eshtë i njohur roli i Esnafit të Tabakeve jo vetëm në jetën ekonomike, por edhe në jetën shoqërore e politike të mbare qytetit. Ndonese shekulli XIX njohu renien e tij, jehona e bemave të tij të dikurshme, të guximshme dhe plot lavdi, ruhej në kujtesën popullore. Lagjja Tabake perfshinte dy objekte shumë të rëndësishme për zhvillimin shpirtëror dhe kulturor të qytetit: Xhaminë e Plumbit dhe Medresenë e Qafes, vepra të Mehmet Pashë Plakut.

Familja Kellici, sic quhej me parë, mori mbiemrin e lagjes dhe Esnafit të Tabakeve. Një mjedis i ngrohtë, një vater ku nuk e shua kurrë zjarri i dashurisë për atdhe dhe për dije, ka qenë ajo e familjes së Myftijëve të Tabakeve. Në këte familje lindi dhe u edukua Jusuf Tabaku, i njohur prej popullit "Myftia Plaku". Të parët e kesaj familjeje paten ardhë prej Ulqinit; llagapi i parë ka qenë "Kellici", por që u zëvendësua me atë "Myftia", pasi Jusuf Efendia qendroi për shumë vjet Myfti.

I pari i familjes ka qenë Osman Kellici, rrobaqepës i kostumeve kombëtare, ndërsa i biri i tij, Hasani, ka qenë kadi i Shkodrës në vitin 1973. Pas tij vjen Abdulla Kellici, babai i Jusuf

Efendiut, i cili pat lane dy djem, Abdullahin dhe Abdurramanin, me dy trashëgimtarët e tij, të mirënjohur klerik, Esatin dhe Muhametin.

Jusuf Tabaku studimet e para i mori në Medresenë e lagjes Qafe, për të vazhduar më vonë me studimet e larta në Stamboll, duke u kthyer në Shkodër me detyrat e imamit.

Në kohë levizja kombëtare po shenonte një rritje të shpejtë dhe të vazhdueshme, duke gjetur shprehje në forcimin e ndergjegjes kombëtare, në ngritjen politike dhe në forcimin organizativ të levizjes. Në çdo fazë të kesaj levizjeje, Jusuf Tabaku që pjesëmarrës apo drejtues dhe frymëzues i veprimeve të ndryshme.

Keshtu atë e shohim përkrah kryengritjeve të fuqishme kundër Tanzimatit të udhëhequra nga Hamz Kazazi e tjerë, por edhe në revoltën e vegjelisë qytetare shkodrane që drejtohej nga Haxhi Sheh Shamia. Ky përkushtim i kushtoi internimin në Stamboll me një grup shkodranësh. Pasi u lirua nga internimi, që zgjedhur anetar i Keshillit Administrativ, por për qëndrimin e tij kundërshtues, pas disa muajsh u shkarkua nga detyra.

Në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, Jusuf E Tabaku mori pjesë aktive. Shkodra u bë një qendër jo vetëm e veprimtarive politike, e mbledhjeve dhe mitingjeve popullore, por edhe e organizimit të repartëve të armatosura në luftë për mbrojtjen e trojeve tona në Plavë e Guci, në Hot e Grudë, e së fundi në Ulqin. Janë të njohura memorandumet dhe protestat e shkodraneve dërguar diplomateve të huaj dhe Kongresit të Berlinit në mbrojtje të trevave shqiptare që po sakrifkoheshin. Pas firmës së Daut Boricit, i dyti nënshkrim është ai i Jusuf Efendi Plakut që vazhdohet nga 380 të tjerë. Në këto vite të zjarra Shkodra luajti një rol më rëndësishëm dhe në mes të personaliteteve më të shquara del edhe Jusuf E Tabaku. Me renien e Ulqinit shumë familje ulqinake emigruan në Shkodër. Që Shkodra ajo që i strehoi dhe i perkrahu vellezrit e vet ulqinake. Komiteti për të organizuar ndihmat u kryesua prej Jusuf E Tabakut, ndonese ishte në moshën 33 vjecare; percaktues këtu qenë autoriteti i tij moral dhe përkushtimi i tij fetar atdhetar.

Jeta e Jusuf Tabakut është e lidhur jo vetëm me jetën politike të Shkodrës, por në mënyrë të vecantë me jetën kulturore, arsimore e fetare të vendit. Si personalitet i shquar me një kulturë të gjere orientale, tërë jetën e tij të gjatë e kaloi me libra duke studiuar sa në bibliotekën e vet, sa në

medresenë e Qafes dhe atë të Pazarit, vepër e Kara Mahmud Pashës, ku kishte edhe atje biblioteka mjaft të pasura. Në sajë të përkushtimit të vecantë ndaj studimit dhe të përgatitjes së tij të gjere profesionale, ish-nxenesi i dikurshëm i Medresesë së Qafes, u afirmua dhe si mesimdhënës (myderiz) i talentuari po atij institucioni, duke e shtrire kontributin e tij në Medresenë e Pazarit, në cilësine e lektorit dhe keshilltarit, për të vazhduar si mesues i Ruzhdijes (shkolle qytetëse publike) e Pazarit dhe anetar i Komisionit Provues të saj.

Për bibliotekën Kellici, sic quhej biblioteka e Myfti Plakut, është shkruar gjatë nga studiues të ndryshëm në kohë të ndryshme, që nga Filip Fishta, Bardhyli, Shefik Osmani e deri tek Hamdi Bushati e Jup Kastrati. Biblioteka Kellici është një nga më të vjetrat që njihen në Shkodër, por si bibliotekë familjare është më e vjetra. U themelua nga Hasan Kellici që nga viti 1750, por u shtua dhe u sistemua nga nipi i tij, Jusuf E. Tabaku. Kjo bibliotekë deri në vitin e 1967 ka qenë e rregjistruar dhe e sistemuar në një dhomë të vecantë, Oda e Qitapeve; kishte rreth 2000 libra të inventarizuar e të vulosur, me etiketa perkatese. Në këte numer perfshiheshin libra të shtypur dhe ato të shkruar me dorë e të lidhura mirë me karton nga vete Myfti Plaku. Librat perfshihnin fusha të ndryshme të dijës: teologji, filozofi, drejtësi, libra shkencore, histori, gjeografi, fizike, astronomi, etj. Dominonin gjuhët orientale, por kishte edhe në gjuhën shqip me alfabet arab (doreshkrimi "Vehbie" i Tahir E. Gjakoves, një abetare shqip, dy tabela astronomike të rilindasit të madh, të Hasan Tahsinin, kujtim nga vizita e tij në Shkodër). Janë këto fakte me interes që prof. Jup Kastrati, në një studim të tij i sugjeruan këtë hipotezë: "Derisa në Bibliotekë (të Jusuf Tabakut N. B.) gjindet një dorëshkrim shqip nga Shkodra, një Abece shqipe nga Stambolla, dy tabela astronomike të një dijetari nga Konispoli, na bëjnë të besojmë se aty duhet të ketë edhe dokumenta të tjerë të rëndësishëm".

Biblioteka u shkatërrua plotësisht tre here: herë e parë zjarri i vitit 1850 (municipioni i depove të kalasë), herë e dytë genocidi kulturor komunist, dhe herë e tretë, me tragjiku, zjarri i viteve të fundit, ku nuk përjashtohen edhe skenaret antikombëtare.

Si përfundim, theksojmë se Jusuf E Tabaku që një qytetar i denjë dhe shumë i nderuar, kujtimi i të cilit ruhet i gjallë në memorjen qytetare: Myfti i Shkodrës për 36 vjet, një fakt shumë i rrallë, myderiz (profesor) i Medresesë, me një kulturë shumë të gjere orientale, studiues i pasionuar deri në castet e fundit të tij, themelues i njeres prej bibliotekave më të vjetra private e më të pasura të Shkodrës, interpretues dinjitoz i ligjeve, pjesëmarrës aktiv në të gjitha ngjarjet e vullshme të shekullit XIX, ngjarje që cuan në shpalljen e pavaresisë së vendit. Ai bashkëpunoi me personalitetet më të shquara të kohës, si Hamz Kazazi, Sheh Shamia, Hodo Pashë Sokolin, Daut Boricin, Hafiz Ali Ulqinakun, Hasan Tahsinin, etj.

Ky burrë i shquar është ndera e familjes, e lagjes, e shkollës që mban emrin, e qytetit dhe e mbare vendit, prandaj, duke perkujtuar emrin dhe veprën e tij, lahet një borxh i madh jo vetëm ndaj figureve të tij, por edhe ndaj historisë dhe kulturës sone.

Lajme nga Bota Islame

Mblodhi: **Mirsad SYLJA**

Kongresmeni i parë musliman në SHBA takohet me udhëheqëset e Grave muslimane në Washington

Një grup prej 25 grave nga e tërë bota takohen në Washington D.C me kongresmenin e parë musliman në Dhomën Përfaqësuese. Kongresmeni Keith Ellison foli me disa gra udhëheqëse të shoqatave të ndryshme islame. Ky është një program i cili sponzorohet nga Kongresi dhe Universiteti i Xhorxh Washingtonit.

Keith Ellison vjen nga distrikti i Minesotas, dhe ai i këshilloi gratë muslimane të punojnë sa më shumë nëpër zyre publike. "Mos shko nëpër vendet ku ka musliman dhe t'i thuash atyre, unë jam musliman, voto për mua. Mos e bëjë këtë." Ellison fitoi një vend në kongres vitin e kaluar. Dhe si një aktivist i vyeshëm i këtij komuniteti, ai u mundua t'i inspiroj gratë muslimane me një mesazh. "Angazhimet civile janë shumë të rëndësishme, pasqyrojnë demokracinë dhe zëri i tyre është shumë i rëndësishëm."

[http:// islamgjakova.net](http://islamgjakova.net)



Luksemburg: Islami zyrtarisht pranohet si religjion

Ministri për kulturë i Luksemburgut, Francois Biltgen, paraqiti konventën e re së bashku me muslimanët. Sipas kësaj konvente, Islami në Luksemburg do të fitoj të drejtat e njëjta me religjionet tjera. Muslimanët e Luksemburgut, afro 8'000, do të përfaqësohen nga një Këshill prej pesë imamëve dhe myftiut (Shura). Ky Këshill do të jetë partner në bisedime me shtetin. Anëtarët e këtij Këshilli do të paguheshin si punëtor shtetëror. Muslimanët, ndërmjet tjerash, do të kenë të drejtë të formojnë bashkësitë e reja fetare, dhe të ndërtojnë xhamia.

Myftiu duhet të bëjë betimin në Kushtetutë dhe me këtë të zotohet se bashkësia e tij fetare do t'i respektoj ligjet dhe rendin publik."Konventa nuk i jep asnjë bashkësi fetare më shumë të drejta nga ato të cilat janë përmendur në Kushtetutë", tha ministri Biltgen.

[http:// islamgjakova.net](http://islamgjakova.net)

Dr. Wyaat Woodsmal pranoi Islamin

Specialisti i njohur botëror mbi zhvillimin individual Dr Wyaat Woodsmal pranoi të jetë në radhën e muslimanëve. Themelues dhe kryetari INLPTA-së (International NLP trainer association) dhe specialisti i parë botërorë i NPL së (zhvillimi individual) Dr Wyatt Woodsmall pranoi fenë Islame. Specialisti i njohur botëror mbi zhvillimin individual, amerikan Dr Woodsmall, në një seminar ku ishte edhe vet pjesëmarrës në Bahrejn deklaroi publikisht se ka pranuar Islamin

Dr Woodsmall ofron shërbime që 25 vjet në zhvillimin individual në 25 shtete të ndryshme, autori i shumë librave dhe punimeve në këtë drejtim.

[http:// mesazhi.com](http://mesazhi.com)



Rusia bën një kopje të artë të Kur'anit

Ka marrë një vit e gjysmë kohë për ekspertët rusë për ta mbaruar një kopje të artë të Kur'anit.

Zyrtarët dhe intelektualët rusë lajmëruan se Federata Ruse thellësisht respekton Islamin, vlerat e tij dhe trashëgiminë e tij, duke cituar bërjen e një kopjeje të Kur'anit të Shenjtë nga ari.

Në një ceremoni të mbajtur në Muzeun Bushkin të Arteve të Bukura, duke shënuar mbarimin e një Kur'anit të këtillë, Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë Alexander Sultanov, tha se kjo ngjarje reflekton përkujdesjen në rritje të Rusisë ndaj trashëgimisë civilizuese Islame dhe vlerave të pasura të tij. Ekspozimi i Kur'anit të Artë në këtë vend paraqet një tregues të koekzistencës ndërfaqetare në Rusi, tha ai, duke përshëndetur Rusinë si vendin unik që siguron një oazë komfore për bashkëekzistimin ndërmjet religjioneve qiellore

Zyrtari rus vuri theks rëndësishëm në thellimit të trashëgimisë kulturore dhe civilizuese të religjioneve si pjesë të përpjekjeve për kristalizimin e civilizimit Rus, dhe duke lavdëruar iniciativën ruse se ka ardhur në një kohë kur bota është e ndërthurur me shumë mospajtime ndërmjet pjesëtarëve të religjioneve të ndryshme.

Në ceremoni morën pjesë ambasadorë arabë dhe muslimanë, klerikë, orientalistë dhe përfaqësues të medieeve. Nga ana e tij përfaqësuesi i Ligës Arabe në Federatën Ruse Gomaa al-Farjani, vlerësoi lartë këtë gjest të Rusisë, në kohën kur civilizimi Islam është duke u shpërftuar padrejtësisht nga të katër anët.

Ai poashtu vlerësoi lartë qëndrimin favorizues të marrëdhënieve të tanishme të Rusisë ndaj botës muslimane dhe arabe.

<http://worldbulletin.net>

Dy ushtarë amerikanë në Afganistan bëhen muslimanë

Rrjeti informativ Rojter bën të ditur se dy ushtarë të cilët kishin shërbyer në bazën e aeroportit të Begradit në periferi të Kabulit pas studimit të fesë islame ishin kthyer në fenë Islame. Vlen të theksohet se vitet e fundit është shtuar numri i perëndimorëve që janë duke u kthyer në fenë Islame, pas studimit të Islamit dhe duke hyrë kontakte me muslimanët praktikant të fesë.

[Http:// mesazhi.com](http://mesazhi.com)



PERRALLA ME AUTOBOMBAT NE TENTATIVE NE ANGLI



Kur politikani i njohur anglez, Toni Bler, e la detyrën e kryeministrit ,pasardhësi i tij Gordon Braun shpejtoi të bindë opinjonin publik botëror se ai do të vazhdojë linjën e Toni Bler duke vazhduar të jetë pjesa më e ashpër e luftës kundër terrorizmit (Nënkupto luftë kundër botës islame).Për të qenë bindës në këtë strategji të rrezikshme dhe anti njerëzore, qeveria e re angleze, me kryeministrin e ri ,Gordon Braun ,inskenuan ata që u quajtën atentatet me autobomba në tentative që u bënë lajmi i pare në mediat angleze dhe ato botërore ,duke na bërë të dyshojmë që në fillim për vertetësinë e ketyre akteve që e ngritën deri në qiell alarmin se popullata e Londrës u rrezikua nga një katastrofe e përmasave të papara.Në komunikatën e policies së Londrës u tha se në qendër të qytetit janë gjetur dy autobomba që, po të kishin shpërthyer, do të kishin bërë një masakër të vërtetë.Komunikata shtonte se në automjete u gjetën bombula gazi . gozhdë dhe lendë shpërthyes.Nuk kaluan vetëm pak orë dhe në ekranet televizive në të gjithë botën u pa kryeministri Gordon Braun me ministren e mrendshme me fëtyra të egërsuara duke u betuar se qeveria e re do të luftojë pa mëshirë terrorizmin.Në këtë situatë të acaruar, të gjithë prisnin të njihnin autorët që përgaditën atentatet dhe që rrezikuan kaq jetë njerëzish.Ne fakt, enigma nuk zgjati shumë, sepse burimet e sigurisë angleze informuan se bëhet fjalë për një vepër të militantëve islamikë në Londër ,të cilët më vonë do të dilnin të lidhur edhe me AL KAEDEN,version ky tashmë i dalur boje për mungesë të shkallës së vertetësisë.Alarmi filloi të amplifikohet kaq shumë sa u bë e ditur se është mbledhur për këtë qëllim edhe Komiteti Britanik i Sigurisë për të analizuar këto atentate. Pasi u bombardua opinjoni publik mrenda

Anglisë dhe jashtë hapësirës së saj ,qeveria e z.Gordon Braun kaloi në fazën e dytë të këtyre atentateve, duke arrestuar disa mjekë të dyshuar për angazhimin e tyre direk në këto atentate dhe më tej ata u akuzuan për lidhje me celula të tjera terroriste ne Australi dhe në Egjipt .Por ,kështjella, që ngritën shërbimet angleze me urdhër pa tjetër të kryeministrit të ri, ishte ngritur mbi themele prej rëre ,sepse mediat njoftuan këto ditë se mjeku ,që ishte i dyshuari kryesor, është i pafajshëm ,sepse akuza kundër tij u rrëzua për mungesë faktesh ..Duke i analizuar nga një kënd tjetër ,alibia për atentatet në tentative merr pamjen e një përralle të rrezikshme ,sepse ato që bëjnë autobomba ,pa tjetër që nuk i japin kujt mundësi që t,i zbulojë ato , kur dihet se ato shpërthejnë me telekomandë.Nga ana tjetër, vetë muslimanët nuk janë të interesuar të bëhen pre e raprezaljeve të autoriteteve, që u rrijnë gati për t,u vënë prangat.Ngarjet, që precipituan më vonë, treguan se qeveria e re angleze kërkonte mandat për të bastisur dhe tmerruar familjet muslimane me kontrole të befasishme në çdo kohë . Dhe mandatin ajo e gjeti me inskenimin e atentateve me bomba të mbetura në tentative.Duket se Gordon Braun do t,ia kalojë paraardhësit të tij,Bler, në angazhimin e tij në masakra kundër muslimanëve.

Gjatë vizitës që ai bëri në SHBA,kryeministri i ri i Anglisë deklaroi në media se e gjithë bota i ka borxh të madh Amerikës ,që po lufton terrorizmin. duke harruar se vetë populli amerikan tashmë e ka penalizuar rendë luftën që po bën Amerika në Irak dhe Afganistan duke i dhënë qeverisë së sotme amerikane një mbështetje që është më poshtë se 40%, Kjo tregon se lufta në emër të një beteje me terroristët është

një fasadë e cila fsheh prapa interesa ekonomike , larje borxhesh të vjetra dhe pa tjetër dhe urrejtje patologjike fetare ndaj atyre që penalizohen si terroristë.Tashmë jehona e atentateve të inskenuara të Londrës, ku u gjetën "rastësisht"në një vend lendë plasëse , gozhdë dhe bombula gazi të gatshme për të bërë një hata,ka kaluar duke na lënë në pritje të një atentati tjetër, i cili do të shpërthejë dhe do të bëhet i njohur për opinjonin publik ,kur të kenë arsye ato që i planifikojnë këto atentate për të krijuar hapësira që u nevojiten për të akuzuar dhe sulmuar muslimanët ,të cilëve duket se forcat antiterror tashmë u kanë shpallur luftë, ku pa tjetër bën pjesë edhe kryeministri i ri i Anglisë, Gordon Braun ,të cilit tashmë i duhet të luftojë , jo vetëm në frontin kundër muslimanëve ,por i duhet të luftojë edhe kundër frontit që i kanë hapur përmbytjet e tmerrshme , i duhet të luftojë edhe kundër viruseve që nuk po i ndahen asnjehere popullit të tij.Ne i urojmë Gordon Braun të fitojë betejën me përmbytjet dhe me virusen. Por, i kujtojmë gjithashtu, se betejën me muslimanët e ka të humbur, sepse muslimanët janë njerez paqedashës, por dine të mbrohen dhe të luftojnë ashpër, kur ato penalizohen dhe sulmohen pa të drejtë Ato e kanë udhëzim të ecin vetëm në rrugën e Allahut të madhërueshëm ,e cila është rruga e vetme e drejtë për të gjithë njerëzimin.

SELIM GOKAJ
Shkodër ,me 6 korrik 2006

Puno për të përsosurën , por mos u justifiko me paaftësinë!!!



Cdo ditë shkelim mbi vetveten si mbi tokë , flasim , pijmë, hajmë , , krijojmë skena coroditëse dhe në fund , justifikohemi ,se nuk jemi të aftë për t'i ndryshuar rrethanat. Ky mentalitet shqiptar është përbiruar thellë në cdo sorollatje të dendur sikur infektimi i mishit të dhëmbit. Nga goja dalin tinguj të paartikular mirë pasi kemi hedhur mjaft hedhurinë mbi dhëmbë e jemi bërë vartës të idesë së prapambeturisë. Studentët paaftësinë e tyre e justifikojnë me një fjalë; unë do t'i bëjë në motë të gjitha dhjetëshe e hoxhallarët krijojnë një xhemat të përsosur me mendjen e tyre , profesorët mendojnë se e gjithë bota gjendet në to , politikanët fshehen pas liturgjisë së fshehte të " udhëheqësit shpirtëror" të tyre dhe në këtë mënyrë e justifikojnë paaftësinë e tyre. E të gjithë këto dëshirojnë që t'i ndryshojnë rrethanat , të ndjekin ritmin e jetës dhe të hudhen në vallen e oqeanëve, sikur fluksi i vdekur i pendimit.. Sikur vërtet studentat do të punonin dhe nuk do të flitnin për dhjetëshet por do t'i posedonin ato , sikur hoxhallarët të rendnin pas xhematit do të krijonin një xhemat mjaft të madh dhe objektiv. Sikur tek profesorët do të depërtonte modestia , dituria e tyre do ta vërshonte një botë të tërë dhe sikur politikanët do të flisnin të vërtetën , e Vërteta do të sundonte mbi rruzullin tokësor...

Ah , Ky term sikur më është bërë kob i zi në mendjen dhe zemrën time.. Mendohej që ta përqafoj dhe me të ta luftoj cdo padrejtësi në rruzullin tokësor. Mendohej që valcerin e fundit ta luaj nën ulurimën e këtij termi kaq magjik dhe të paarritshëm. Sikur ...

Shumica e shqiptarëve, kur e ndiejnë veten inferior, tregojnë para botës se kush kemi qenë , cka kemi bërë dhe se si kemi qenë? Bota , nuk na pyeti se kush kemi qenë e as që kërkoi nga ne që t'i tregojmë se çfarë kemi bërë dhe se si kemi qenë Ata muarën modelin e civilizimit dhe vazhduan përparimin e teknologjisë dhe lëmvive të ndryshme shoqërore. Zakonisht, kur rri me historiane ato më sugjerojnë që argumentet historike t'i cekë dhe t'i përmend vetëm kur devijohet ajo , por edhe për ta ndryshuar për të mirë të ardhmen time. Por , fatkeqësisht në një rreth, ku jetojmë është shumë vështirë që të gjitha këto qëllime t'i hedhim me një vend të përpjestueshëm më idenë e ngritjes dhe vetëdijes shoqërore. Historia ka ndryshuar në trajtë prej atij momenti, kur filloi të përdoret për justifikimin tonë për mos t'i ndryshuar dhe lëvizur proceset përpara. Unë e di se njëra prej odave të para tregtare në Ballkan ka qenë në Shkodër , por kjo për mua nuk vlen gjë , kur sot nuk di termin odë tregtare dhe kur nuk justifikoj

veten time me punë e me kërkime shkencore. Esenca e këtyre plagjiaturave pompoze, që po sjellen në mendjen e cdo njeriu të ri ka qëllim që këte rini ta nxije me fjalë qymyri e humbje kohe dhe me dyndje dashurie..

Është e drejtë e cdo njeriu që ta kërkojë punën e përsosur , por nuk është e drejtë e askujt që, derisa të arrijë tek përsosmëria, të flejë dhe të pres që rrethanat do t,i ndryshojnë shumica tjetër. Puna e përsosur nuk arrihet me qëllime të fshehta dhe trashanike sepse ata janë në kundërshtim me vete individët që duhet të kapërcejnë ato punë . Puna e persosur arrihet me mirësinë , rritjen e mirëqenies ekonomike , investimet në degëzime të caktuara ekonomike , profilizimi i kuadrove etj. Një here, Venko Andonovski, një shkrimtar maqedon , e patën pyetur se cka mendon për pavaresinë e Maqedonisë . Ai ia ktheu përgjigjen në këtë mënyrë : " Pavaresia e Maqedonisë do të arrihet vetëm kur secili do të jap të pamundurën në drejtimin e vet..." Ka pase të drejtë shkrimtari i nderuar edhe pse i përket popullit maqedon. Ky shembull mund të mirret edhe për ne si burim referimi , A thua vallë ne do ta ndryshojmë gjendjen tonë, kur rinia shqiptare do ta harrojë përfundimin e sopatave dhe kanaleve , kur politikanët tanë do të kalojnë nga makiavelizmi në demokraci??/ Kjo pyetje është e pafundme , nëse nuk fillojmë nga vetvetja që të mendojë ndryshe dhe të veprojmë ndryshe në dobi të ndryshimit të rrethanave. Nuk duhet që të rrijmë dhe t'i shikojmë të tjerët se si ecin përpara për shkak të mosaftësisë sonë , sepse, nëse sot puna jonë do të jetë e papërsosur, nëse me papërsosmërinë tonë nuk veprojmë drejtë përsosmërisë ne jemi në humbje dhe për shumë vite me rradhë do ta ndiejmë shembjen e ndërtesës së quajtur shqiptari... Këtë shkrim po e përfundoj me porosinë e profesorit turk Bekir Topaloglu i cili thotë:" Para cdo gjëje duhet të themi se ai, që nuk mund te rregullojë veten , bashkëshorten , pjesëtarët e familjes dhe ata që i ka nën vete , s`ka dyshim se nuk mund të ndikoj mbi të tjerët.."

**Hamdi Nuhija
SHKUP**

Falënderim

Falënderojmë besimtarët myslimanë të Shkodrës, Tiranës, Kavajës dhe më gjerë, që kontribuojnë me sadaka për financimin dhe shpërndarjen e gazetës "Besimtari"

All-llahu ua shpërbleftë më xhennete këtë sadaka e cila synon përmes gazetës "Besimtari" të përcjellë mesazhe islame dhe të mbrojë interesat e myslimanëve në të gjitha hapësirat shqiptare dhe më gjerë.

**Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Redaksia e gazetës "Besimtari"**

Bordi drejtues dhe bashkëpunëtorët e gazetës

**Vehbi Dani
Olsi Jazexhiu
Selim Gokaj
Bashkim Bajraktari
Hysen Kazazi**

**Faqosja:
Gazjon Rusi
Radhitja:
Ditmir Gokaj**

www.gazetabesimtari.com

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Bismil-lahi Rrarhmanirr-rrahim

Klientë të nderuar! Vëllezër dhe motra muslimane, market "ISMETI" ju garanton:

- 1- *Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk,*
- 2- *Pizeri hallall*
- 3- *Fast Food hallall*

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893



EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT

ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bamiress Islam), ju afrohem prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zyresh
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokalesh
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbetenit te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

